

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA DURDAJ DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesat nr. 63543/09 dhe 3 të tjera – shihni listën bashkëngjitur)

VENDIM

Neni 2 (procedural) - Efektiviteti i hetimit dhe zhvillimi i ndjekjes penale për shpërthimin në objektin e çmilitarizimit të armëve në Gërdec që rezultoi në vdekje dhe plagosje të rënda - Hetimi adekuat në kuptimin që përcakton rrethanat e ngjarjes dhe çon në identifikimin e përgjegjësve - Dhënia e aksesit në hetim kërkuesve në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime - Dënimet ndaj të akuzuarve kryesorë, në lidhje me aktet që rrezikojnë jetën dhe mbrojtjen e së drejtës për jetë sipas kuptimit të nenit 2 - Çështja në fjalë nuk kishte të bënte me vrasje me dashje, dënimet me burg dhe koha e vuajtur në burg janë jo haptazi në disproporcion me rëndesën e veprave të kryera - Kërkuesve nuk u jepet mundësia për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedimin penal kundër të akuzuarve - Procedimi penal kundër ish-ministrit të Mbrojtjes është ende në proces për mbi katërmbëdhjetë vjet, i rrezikuar nga vonesat e konsiderueshme, inercia e autoriteteve të ndjekjes penale dhe përpjekjet e kota të kërkuesve për ta sjellë atë para drejtësisë

Neni 2 (material) - Viktima - Mosshterimi i mjeteve juridike të brendshme - Kuadri adekuat përkatës ligjor dhe rregullator vendës që ofron bazën ligjore për të kërkuar dëmshpërblim nga shteti – Pranimi në thelb në procese administrative të filluara nga disa kërkues i përgjegjësish së shtetit, në lidhje me aspektin material të nenit 2, së bashku me dhënien e dëmshpërblimit që çon në humbjen e statusit të viktimës së atyre kërkuesve - Mosparaqitja e padisë ndaj shtetit për dëmshpërblim civil nga kërkuesit e mbetur

STRASBURG

7 nëntor 2023

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 paragrafi 2 i Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikim redaktorial.

Në çështjen Durdaj dhe të Tjerë kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *Kryetar,*

Jolien Schukking,

Yonko Grozev,

Ivana Jelić,

Darian Pavli,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Milan Blaško, *Kancelar Seksioni,*

duke pasur parasysh:

kërkesat (nr. 63543/09, 46707/13, 46714/13 dhe 12720/14) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituara në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive

Themelore të Njeriut (“Konventa”) nga shtatëmbëdhjetë shtetas shqiptarë (“kërkuesit” më 29 janar 2014, 28 maj 2013 dhe 9 nëntor 2009, përkatësisht;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) për ankimet sipas aspektit procedural dhe material të nenit 2 të Konventës dhe nenit 13 dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesave;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 10 tetor 2023,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me shpërthimin në objektin e Gërdecit për çmilitarizimin dhe çmontimin e armëve, makinerive dhe pajisjeve të vjetruara të Forcave të Armatosura, që rezultoi në vdekjen e të afërmeve të kërkuesve ose në plagosje të rënda në trupin e tyre. Mbështetur në nenet 2 dhe 13 të Konventës, kërkuesit pretenduan që Shteti nuk kishte mbrojtur të drejtën e tyre ose të të afërmeve të tyre për jetën dhe që hetimi penal për ngjarjen nuk kishte qenë efektiv.

FAKTET

2. Kërkuesit u përfaqësuan nga z. D. Matlija, avokat me licencë në Tiranë. Detajet e kërkuesve jepen në tabelën bashkëngjitur.

3. Fillimisht qeveria përfaqësohej nga Agjencia e saj znj. E. Muçaj dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

I. SFONDI I ÇËSHTJES

5. Pas rënies së regjimit komunist, gjatë të cilit një pjesë e madhe e fokusit dhe burimeve të Shqipërisë u kushtuan sistemit të mbrojtjes së vendit, u vlerësua se forcat e armatosura shqiptare kishin një rezervë prej 185,000 ton municionesh të depozituar në 1300 depo në të gjithë vendin. Përballë rrezikut që ky municion përbënte ndaj jetës dhe shëndetit të popullatës, veçanërisht pas rënies së skemave piramidale në vitin 1997 dhe grabitjes së depove të armëve, autoritetet filluan procesin e çmilitarizimit dhe shkatërrimit të stokut të municioneve. Fillimisht çmilitarizimi u krye në tri objekte ushtarake në pronësi të dhe të kontrolluara nga shteti (Poliçan, Mjekës-Elbasan dhe Gramsh).

6. Më 14 mars 2007, Këshilli i Ministrave (dega ekzekutive e qeverisë së Shqipërisë) miratoi vendimin nr. 138 që përcakton procedurën për çmontimin e armëve, makinerive dhe pajisjeve të forcave të armatosura të çmilitarizuara dhe të vjetruara, si për përdorim ushtarak ashtu edhe joushtarak.

Lejet për eksportin e armëve, makinerive, pajisjeve, municionit dhe eksplozivëve do të jepeshin nga Ministria e Mbrojtjes.

Municionet, armët, makineritë, pajisjet dhe eksplozivët e forcave të armatosura mund të shiten për qëllime muzeale, koleksioni apo për përdorim tjetër civil, vetëm pasi të çmilitarizohen (bëhen të paefektshme si armë). Procedurat e çmilitarizimit përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes dhe udhëzim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Kompanisë së Eksport-Importit Ushtarak (“MEICO”, kompani e krijuar me vendim qeverie në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes) iu besua kryerja e procedurës për shitjen e municioneve për qëllime çmilitarizimi dhe lidhja e kontratave përkatëse.

Çmimet e shitjes do të caktoheshin dhe miratoheshin nga një komision i krijuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes dhe i përbërë nga ekspertë financash, juristë dhe ekonomistë.

Një departament i Ministrisë së Mbrojtjes mund të shkatërronte dhe të asgjësonte armët, makineritë, pajisjet, municionet dhe eksplozivët e çmilitarizuar dhe të vjetruar.

Neni 4 i kreut IV të vendimit nr. 138 parashikonte që procesi i çmilitarizimit e çmontimit të kryhej nën mbikëqyrjen dhe sigurinë ushtarake të reparteve të Forcave të Armatosura.

Vendimi i Këshillit të Ministrave autorizoi, gjithashtu, shitjen, çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve me qëllim reduktimin e stokeve të municionit të vjetruar të kalibrit të vogël.

7. Më 25 prill 2007, ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin nr. 550 për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 14.3.2007. Aty, *inter alia*, lexohet si vijon:

“Urdhëroj... municioni i kërkuar (100 milionë fishekë me gëzhoja tunxhi 7,62x54 mmR, 20 milionë fishekë me gëzhoja tunxhi 12.7 mm dhe 20 milionë fishekë me gëzhoja tunxhi 14,5 mm) të transferohet te MEICO për shitje për qëllime asgjësimi dhe nxjerrje jashtë përdorimit brenda vendit me ndihmën e [Southern Ammunition Company]; dhe a) të udhëzohet komanda e forcave të armatosura që për këtë të sigurojë përdorimin e një sipërfaqe toke nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes në Gërdec, në bashkinë Vorë...”

Komandës së Forcave të Bashkuara iu besua: i. vënia në dispozicion e një sipërfaqeje toke nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes me vendndodhje në Gërdec (Vorë) për procesin e çmilitarizimit; ii. transportimi i municionit në objektin e Gërdecit sipas planit të përcaktuar me MEICO-n; iii. ruajtja e objektit dhe kontrolli i regjimit të hyrje-daljeve të punonjësve të tij në ambiente; dhe iv. lidhja e një kontrate qiraje me një kompani të themeluar në SHBA, Southern Ammunition Company (“SAC”).

8. Më 22 tetor 2007, ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin nr. 1800, në përputhje me të cilin ministri i Mbrojtjes vendosi pronën ku ndodhej objekti i Gërdecit nën administrimin e MEICO-s, e cila më pas e vuri në dispozicion të Albademil sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri, pa kontratë qiraje.

9. Më 7 dhjetor 2007, ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin nr. 2044 për çmilitarizimin dhe çmontimin e municioneve. MEICO-së iu besua vënia e objektit të Gërdecit në dispozicion të SAC për procesin e çmilitarizimit. MEICO u urdhërua të lidhë kontratë me SAC dhe, ndër të tjera, të respektojë zbatimin nga kontraktori të procedurave standarde të sigurisë, masave të mbrojtjes nga zjarri dhe të sigurojë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personave të punësuar gjatë çmilitarizimit dhe çmontimit të municioneve nën kushte të rrepta mbikëqyrjeje dhe sigurie. MEICO dhe Komanda e Forcave të Përbashkëta do të mbikëqyrnin objektin e çmilitarizimit dhe depon e municioneve.

10. Ndërkohë, më 6 qershor 2007 MEICO lidhi një kontratë pesëmujore me SAC për shitjen e rezervave të municioneve për qëllime çmilitarizimi. Objektivi i kontratës ishte çmontimi vetëm i municioneve të kalibrit të vogël (7,62–14,5 mm). Kontrata përcaktonte që SAC do të siguronte makinerinë për çmontimin e municioneve të kalibrit të vogël dhe do të sillte ekspertë amerikanë për të mbikëqyrur procesin. Sipas kontratës, SAC do të merrte përsipër të menaxhonte dhe të kontrollonte çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve, sipas kushteve dhe masave të sigurisë teknike të përcaktuara në legjislacionin përkatës shqiptar, dhe MEICO dhe Komanda e Forcave të Përbashkëta do të siguronin mbikëqyrjen e objektit të çmilitarizimit. Nga ana tjetër, SAC nënkontraktoi Albademil sh.p.k. për të kryer punën.

11. Ish-Uzina e Prodhimit të Tankeve në Gërdec, një zonë që ndodhet 15 km në perëndim të Tiranës, u caktua si objekti i çmilitarizimit. Çmilitarizimi ishte parashikuar vetëm për armët e kalibrit të vogël (20 mm dhe më të vogla). U raportua se çmilitarizimi ishte kryer pa probleme të theksuara. Në kohën kur po ngrihej objekti i çmilitarizimit të armëve në Gërdec, objektet e tjera të specializuara ushtarake (Poliçan, Mjekës-Elbasan dhe Gramsh) ishin ende në punë.

12. Më 28 dhjetor 2007, MEICO lidhi një kontratë të dytë me SAC për çmontimin e municioneve të kalibrit të mesëm dhe të madh (20–152 mm) me gëzhoja tunxhi, i cili nënkontraktoi sërish Albademil sh.p.k. për të kryer punën.

13. Më 15 mars 2008, rreth mesditës ndodhi një shpërthim masiv në objektin e çmilitarizimit të armëve (“ngjarja e Gërdecit”). Ngjarja vazhdoi për disa orë dhe njëzet e gjashtë persona vdiqën dhe rreth 300 të tjerë u plagosën rëndë ose lehtë. Shpërthimi shkatërroi pronat e 5.829 personave, duke shkaktuar dëme materiale në shumën 2.141.343.616 lekë (LEK) sipas të dhënave të ministrisë së Mbrojtjes në momentin e ngjarjes.

II. KËRKUESIT NË KËRKESAT NË FJALË

14. Kërkuesit në kërkesat nr. nr. 63543/09 dhe 12720/14, Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj, janë prindërit e të ndjerit Erison Durdaj. Në momentin e shpërthimit Erison Durdaj, atëherë shtatë vjeç, po kalonte pranë objektit së bashku me kushërinin e tij, Roxhens Durdaj (kërkuesi i parë në kërkesën nr. 46714/13), për t’i lënë paketimin e drekës nënës së Roxhensit dhe tezes së Erisonit të cilat punonin në objekt. Erison Durdaj mbeti i plagosur rëndë nga shpërthimi dhe u transferua me urgjencë në një spital në Itali, ku vdiq më 3 prill 2008. Roxhens Durdaj, në atë kohë 11 vjeç, mbeti i plagosur rëndë nga flakët e shpërthimit.

15. Të trembëdhjetë kërkuesit e kërkesës nr. 46707/13, si dhe kërkuesja e dytë e kërkesës nr. 46714/13 (Alketa Hazizaj), punonin në objekt dhe u plagosën rëndë nga shpërthimi.

III. HETIMI PENAL

16. Po ditën e shpërthimit, më 15 mars 2008, Prokuroria e Përgjithshme filloi hetimin penal për ngjarjen e Gërdecit. Katër të dyshuarit, Y.P. (drejtuesi i MEICO-s), M.D. (menaxheri i Albademil sh.p.k), D.M. (menaxheri i objektit i punësuar nga Albademil sh.p.k.) dhe S.N. (punonjës i MEICO-s) u ndaluan menjëherë.

17. Autoritetet nuk mund të hynin menjëherë në objekt pasi ngjarja vazhdoi për disa orë. Evakuimi i objektit dhe zonës përreth dhe heqja e municioneve të mbetura nga ekspertët e eksplozivit u bënë në ditët pas shpërthimit.

18. Më 29 mars 2008 hetimi u zgjeruar për të përfshirë edhe ish-ministrin e Mbrojtjes, F.M., i cili në kohën e shpërthimit ishte deputet. Për të vijuar hetimin në lidhje me F.M., nevojitej autorizimi i kuvendit sipas nenit 73 të Kushtetutës. Prokurori i Përgjithshëm kërkoi heqjen e imunitetit të F.M., mbështetur në “dyshimin e arsyeshem të bazuar në prova që tregojnë fajësinë e tij për shpërfilljen e rregullave të sigurisë që kishin çuar në shkaktimin e ngjarjes dhe kishin shkaktuar dëme të mëdha ekonomike për shtetin”.

19. Më 16 qershor 2008, Kuvendi autorizoi hetimin e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me F.M.

20. Nga provat e paraqitura në Gjykatë rezultoi se në kuadër të hetimit janë kryer tri ekspertime. I para është kryer nga Ekipi Ndërkombëtar i Reagimit (IRT) i Byrosë së Alkoolit, Duhanit, Armëve të Zjarrit dhe Eksplozivëve (ATF). ATF-ja është njësi kryesore federale e SHBA-ve për hetimin e incidenteve me eksploziv dhe për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në këtë drejtim. ATF ka autoritet hetimor kombëtar dhe ndërkombëtar. Hetimi i dytë u krye nga Prokuroria e Përgjithshme dhe i treti nga ushtria.

A. Raporti i ATF-IRT

1. Gjetje të përgjithshme

21. Nëpërmjet ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri u kërkua ndihma e ART-IRT për hetimin e ngjarjes së Gërdecit. ATF-IRT u dërgua më 5 prill 2008 për të ndihmuar autoritetet shqiptare, përkatësisht Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokurorinë e Rrethit Tiranë, për vlerësimin e vendit të ngjarjes dhe kryerjen e intervistave.

22. Hetimi për gjetjen e fakteve pas shpërthimit u krye midis 7 dhe 11 prillit 2008 në objektin e çmilitarizimit për të përcaktuar origjinën dhe shkakun e zjarrit dhe shpërthimit.

23. Më 7 prill 2008, ATF-IRT filloi kryerjen e këqyrjes së vendngjarjes, e cila përfundoi më 11 prill 2008. Këqyrja e vendngjarjes përfshinte rikrijimin e vendngjarjes dhe fotografimin. ATF-IRT

ndihmoi me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, vlerësimin e vendngjarjes dhe rikrijimin dhe dokumentimin e ngjarjes. Raporti i tij hetimor vuri në dukje se objekti ishte vënë në punë nga Albademil sh.p.k. dhe se aty kishte ndodhur çmilitarizimi i municioneve ushtarake të vjetruara të kalibrit 20 deri në 152 mm. Informacioni i mbledhur gjatë hetimit tregonte se objekti kishte qenë në punë nga janari 2008 dhe deri në tetë kamionë në ditë sillnin municione për çmontim.

24. Raporti theksonte se procesi për angazhimin e fuqisë punëtore kishte konsistuar në punësimin e një personi me të gjithë familjen e tij ose të saj për të punuar si grup, duke përfshirë fëmijët e moshës 10 deri në 16 vjeç. Një specialist do të mbikëqyrte më shumë se një grup në të njëjtën kohë. Punëtorët fitonin para në bazë të sasisë së municioneve të çmontuara. Raporti hetimor theksoi se ndonëse në fillim të çdo projekti dhe në fillim të çdo dite pune duhej të ishte dhënë informacion për sigurinë, kjo nuk kishte ndodhur gjithmonë, as në ditën e shpërthimit.

25. Në raport thuhej, gjithashtu, se asnjë rregullore për rregullat e sigurisë teknike nuk ishte vënë në dispozicion të punëtorëve në objekt. Intervistat me punëtorët zbuluan se ata nuk kishin pasur një zonë të caktuar për pirjen e duhanit dhe nuk ishin vendosur tabela “ndalohej duhani”. Për më tepër, atyre nuk u ndalohej të mbanin shkrepëse, çakmakë apo duhan në vendin e punës në objekt.

26. Raporti më tej konfirmoi se për punëtorët nuk ishte përcaktuar një uniformë pune. Përveç kësaj, atyre nuk u ishte kërkuar të mbanin veshje antistatike (100% pambuk) dhe as nuk kishin marrë ndonjë udhëzim për shmangien e rreziqeve nga elektriciteti statik. Fotografitë dhe videoregjistrimet e siguruar nga SAC para ngjarjes zbuluan se të paktën një fikse zjarri portative ndodhej në anën juglindore të objektit. Megjithatë, nuk kishte asnjë sistem automatik të shuarjes së zjarrit.

27. Më 15 mars 2008, sasi të mëdha municionesh të të gjitha llojeve ishin dorëzuar nga ora 7 deri në 9 të mëngjesit. Sipas raportit procesi i çmontimit kishte filluar në 9:30 të mëngjesit. Rreth 118 punëtorë të ndarë në njëzet grupe me tri ose katër persona kishin filluar hapjen e kutive ku mbaheshin municionet, për të nxjerrë predha, gëzhoja dhe barut dhe për t'i vendosur ato në vendet e tyre të caktuara.

28. Në mesditë ndodhi një shpërthim. Në momentin e shpërthimit po kryheshin operacionet e çmilitarizimit dhe rreth pesëdhjetë punëtorë ishin në zonën kryesore të përpunimit kur ra zjarri. Punëtorët nuk kishin mundur të shuanin zjarrin për shkak të mungesës së pajisjeve të duhura. Në momentin e shpërthimit ndodheshin 1,067,855 tonë barut, 286,476 tonë lloje të ndryshme lëndësh djegëse dhe 4,365,335 tonë gëzhoja TNT. Ky material ishte vendosur në vende të ndryshme pothuajse në të gjithë sipërfaqen e objektit të Gërdecit.

2. Konkluzionet e hetimit të ATF-IRT

29. Shpërthimi kishte rezultuar në vdekjen e njëzet e gjashtë personave dhe plagosjen e rreth 300 personave. Shpërthimi kishte dëmtuar, gjithashtu, infrastrukturën, si rrjetet e furnizimit me ujë dhe energji elektrike, rrugët, ndërtesat publike, shkollat, kopshtet dhe qendrat shëndetësore.

30. Moti nuk u konsiderua faktor në shpërthim. Më 15 mars 2008 në mesditë temperatura u raportua 18°C, lagështia ishte 94%, dhe kishte erëra veriore me 14.8 km/h, vranësira të shpërndara dhe pa reshje.

31. Shkaku i saktë i zjarrit mbeti i panjohur. Megjithatë, aspektet e metodave të punës mund të kenë çuar në zjarrin me origjinë nga qeset me lëndë djegëse. Gjatë hetimit u bë e qartë se lëndët djegëse si baruti i zi dhe baruti i zi pa tym ishin shumë të pambrojtur ndaj ndezjes nga nxehtësia, elektriciteti statik, fërkimi ose flaka. Bazuar në këqyrjen e vendngjarjes nga ATF-IRT dhe deklaratimet e dëshmitarëve, u konstatua se ngjarja ishte shkaktuar nga zjarri me origjinë në një karrocë të ngarkuar me lëndë djegëse në qese plastike, e cila kishte shkaktuar një shpërthim në shumicën e depove të municioneve dhe lëndëve djegëse në objekt. Zjarri kishte nisur pranë qendrës së skajit jugor të oborrit afërsisht 10 m brenda portës pranë bankës së çmilitarizimit 122 mm.

32. Rrjedha më e mundshme e ngjarjeve bazuar në provat e mbledhura ishte që punëtorët ishin duke lëvizur qeset plastike me lëndë djegëse me anë të karrocave. Lënda djegëse në një karrocë kishte marrë zjarr duke u përhapur në depot aty pranë të lëndëve djegëse dhe kutive prej druri me municione. Zjarri kishte filluar për një kohë të shkurtër derisa kur në fund shkaktoi një shpërthim në zonën ku ishin ruajtur municionet ushtarake të shkrija dhe të pashkrija.

33. Në konkluzionin e tij, raporti nënvizoi një sërë mangësish bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve dhe fotografitë dhe videoregjistrimet para shpërthimit të bëra një muaj para ngjarjes. Ai fillimisht vuri në dukje se procedurat e përdorura në objektin e Gërdecit kishin qenë të pasigurta dhe jo në përputhje me standardet normale të punës në vendet e punës që kishin të bënin me eksplozivë dhe lëndë djegëse. Më tej, ai u shpreh se çmontimi i municioneve ishte kryer nga punëtorë të patrajnuar duke përdorur automjete të cilat nuk ishin në përputhje me standardet e sigurisë. Fotografitë e marra përpara ngjarjes zbuluan se mbeturinat, materialet shpërthyes dhe predhat e shkrija të pasiguruara dhe qeset me lëndë djegëse ishin lënë në dyshe. Për më tepër, veshjet e papërshtatshme që prodhojnë statikë lejoheshin në vendin e punës dhe nuk ishte bërë asnjë trajnim për uljen e rrisqeve nga elektriciteti statik. Në fund, ai u shpreh që një operacion i kësaj përmase nuk duhej të ishte kryer kurrë në një vendndodhje pranë rrugëve publike dhe banesave.

B. Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme

1. Gjetjet në lidhje me kontratën e parë

34. Raporti hetimor konstatoi se deri më 28 dhjetor 2006, F.M. kishte miratuar tashmë ofertën e SAC për lidhjen e një kontrate për çmilitarizimin e municioneve të kalibrit të vogël dhe kishte informuar Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Po në të njëjtën datë, Albademil sh.p.k. u krijua me dy bashkëpronarë, P.H. dhe M.D., të cilët zotëronin përkatësisht një të tretën dhe dy të tretat e aksioneve. Raporti theksonte, gjithashtu, se në vitin 2006 P.H. kishte vizituar disa herë Shqipërinë dhe kishte zhvilluar disa takime me Y.P. (drejtuesi i MEICO-s). Y.P. i kishte dhënë P.H. informacion, në lidhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm në Shqipëri për të krijuar një kompani. Më pas SAC kishte bërë një ofertë, përmbajtja e së cilës ishte në një faks të datës 27 dhjetor 2006.

35. Në raport thuhej se zgjedhja e Gërdecit si vendi i objektit të çmilitarizimit të armëve ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e shtetit. Zona nuk ishte licencuar për ruajtjen dhe çmontimin e municioneve. Gjatë zbatimit të kësaj kontrate ishte kryer çmontimi i materialeve të kalibrit të vogël, 7.62 mm, 8 mm, 12.7 mm dhe 14.5 mm. Në raportin hetimor thuhej se për të punuar në objekt ishin punësuar fëmijë dhe punëtorë me pak ose aspak njohuri teknike. Raporti, gjithashtu, vuri në dukje se ata nuk ishin trajnuar apo udhëzuar ndonjëherë, dhe as nuk ju ishin dhënë udhëzime mbi rregullat e sigurisë. Tre ekspertë amerikanë ishin të pranishëm në objekt gjatë kontratës së parë (për çmontimin e kalibrit të vogël), por jo gjatë kontratës së dytë (për çmontimin e kalibrit të mesëm dhe të madh) apo në ditën e shpërthimit.

36. Kontrata kishte parashikuar nevojën për të bërë një plan transporti (*grafiku i transportit*), por kjo nuk ishte bërë asnjëherë pasi palët nuk kishin arritur të binin dakord për kushtet. Gjatë zbatimit të kontratës së parë, MEICO-s i ishte kërkuar, gjithashtu, të lëshonte tri licenca: i. për çmontimin e municionit; ii. për ruajtjen e municionit; dhe iii. për importin dhe eksportin e municioneve. Raporti theksoi se MEICO nuk kishte lëshuar asnjë nga licencat e mësipërme. Në raport thuhet, gjithashtu, se gjatë periudhës së kontratës së parë, në objektin e çmilitarizimit të armëve kishte rënë zjarr, por ekspertët amerikanë kishin ndihmuar për ta shuar.

37. Raporti doli në përfundimin se municioni ishte çmontuar në ambient të hapur pa asnjë mbrojtje nga shiu apo dielli. Raporti hetimor arriti, gjithashtu, në përfundimin se procesi i çmontimit kishte rritur në masë të konsiderueshme nivelin e rrezikut në objektin e çmilitarizimit të armëve që lindte nga dërgimi, ruajtja, çmontimi dhe çmilitarizimi i mijëra tonëve përbërës të rrezikshëm si

baruti, TNT dhe detonatorët. Më 27 dhjetor 2006, SAC kishte paraqitur një ofertë për çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve, të cilat nuk ishin të disponueshme për përdorim ushtarak. Oferta i ishte dorëzuar drejtuesit të MEICO-s, Y.P., pas disa shkëmbimeve të mëparshme me *email*, faks dhe personalisht. Y.P. me shkresën nr. 1232/523 kishte vënë në dijeni ministrin e Mbrojtjes për përmbajtjen e ofertës, duke theksuar avantazhet financiare për shtetin.

2. Gjetjet në lidhje me kontratën e dytë

38. Më 28 dhjetor 2007 MEICO lidhi një kontratë të dytë me Albademil sh.p.k. Nga hetimi rezultoi se kontrata e dytë përfshinte çmontimin e predhave të kalibrit të madh prej 20 deri në 150 mm, edhe pse F.M. kishte dijeni që MEICO dhe Albademil sh.p.k. nuk kishin teknologjinë e duhur për çmontimin industrial të municioneve përveç atyre të kalibrit të vogël.

39. Në raportin hetimor thuhej se gjatë ekzekutimit të kontratës së dytë, ishin duke u bërë përgatitjet për çmontimin e municioneve që nuk ishin pjesë e stokut të vjetruar të ushtrisë, por që mund të ishin përdorur edhe për trafik armësh.

40. Sipas raportit, çmontimi i predhave të kalibrit të madh kishte filluar rreth javës së tretë të janarit 2008. Puna kryesore përpara shpërthimit kishte qenë nxjerrja e gëzhojave nga predhat, heqja e detonatorëve dhe barutit dhe pastrimi i vendit.

41. Raporti, gjithashtu, vuri në dukje se procesi për angazhimin e fuqisë punëtore kishte konsistuar në punësimin e një personi me të gjithë familjen e tij ose të saj për të punuar si grup. Një specialist mbikëqyrte më shumë se një grup në të njëjtën kohë dhe vendoste normën ditore të punës.

42. U raportua se në fillim të çdo projekti ishte bërë një seancë informimi për sigurinë për çdo lloj material të veçantë. U raportua, gjithashtu, se në fillim të çdo dite pune punëtorët ishin rreshtuar dhe ju ishte dhënë informacion për sigurinë. Megjithatë, nga raporti ishte e qartë se informimi nuk kishte ndodhur gjithmonë, përfshirë ditën e shpërthimit.

43. Asnjë rregullore për rregullat e sigurisë teknike nuk ishte vënë në dispozicion të punëtorëve në objekt. Intervistat me punëtorët zbuluan se ata nuk kishin pasur një zonë të caktuar për pirjen e duhanit dhe nuk ishin vendosur tabela “ndalohet duhani”. Për më tepër, atyre nuk u ndalohej të mbanin shkrepe, çakmakë apo duhan në vendin e punës. Asnjë uniformë pune nuk ishte caktuar për punëtorët. Përveç kësaj, atyre nuk u ishte kërkuar të mbanin veshje antistatike dhe as nuk kishin marrë ndonjë udhëzim për të parandaluar rreziqet nga elektriciteti statik. Fotografitë dhe videoregjistrimet e siguruara nga SAC tregonin se të paktën një fikse zjarri portative ndodhej në anën juglindore të objektit. Megjithatë, nuk kishte asnjë sistem automatik të shuarjes së zjarrit. Nga 12 deri më 14 mars 2018, kamionët kishin sjellë më shumë se 460 tonë predha në objekt. Kishte rreth 1,070 tonë barut të zi, 286,476 detonatorë të llojeve të ndryshme dhe afërsisht 4,365 predha të paprekura në objekt.

44. Tetë kamionë kishin mbërritur gjatë natës së 14 marsit 2008, që kishin transportuar municione. Municionet e mëposhtme ushtarake kanë qenë në zonën kryesore të objektit në ditën e shpërthimit: gëzhoja shpërthyesë 20 mm; predha kundërajrore me eksploziv të lartë 37 mm; dhe predha “të fiksuara” (100 mm dhe 122 mm) dhe predha “gjysmë të fiksuara” (122 mm, 130 mm dhe 152 mm), të dyja me mekanizëm vetëshkatërrues.

45. Kamionët nuk ishin shkarkuar menjëherë për shkak të orës së vonë dhe motit të ftohtë. Një sasi e madhe qesesh plastike që përmbanin lëndë djegëse e cila ishte hequr nga predhat ishin vendosur në qendër të objektit në një vijë që shkon nga veriu në jug. Municionet ushtarake, duke përfshirë predhat 37 mm dhe 100 mm, ishin rreshtuar në muret lindore dhe perëndimore përgjatë gjatësisë së objektit.

46. Qeveria nuk ka dorëzuar një kopje të dosjes hetimore. Ata u shprehën se çështja ishte në dorën e Prokurorisë së Përgjithshme.

47. Prokurori i Përgjithshëm i shkroi një letër Kuvendit për seancën ku u kërkua autorizimi për ndjekjen penale të F.M. Në shkresë lexohej si më poshtë:

“Hetimet e kryera në këtë fazë tregojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se F.M. ka kryer veprime dhe mosveprime të qëllimshme në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore. Këto veprime patën ndikim të drejtpërdrejtë në ngjarjen e Gërdecit. F.M. ka lëshuar urdhrin nr. 550, të 25 prillit 2007, për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, të 14 marsit 2007, që përcakton procedurën për çmontimin e armëve, makinerive dhe pajisjeve të forcave të armatosura të çmilitarizuara dhe të vjetruara, si për përdorim ushtarak ashtu edhe joushtarak. Urdhri është miratuar pa u konsultuar me Shtabin e Përgjithshëm dhe Departamentin e Ministrisë së Mbrojtjes për Harmonizimin e Legjislacionit dhe Marrëdhëniet me Parlamentin, gjë që është e detyrueshme. Kjo është në kundërshtim flagrant me nenin 17 të Rregullores së Brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes.

Më tej, urdhri parashikonte që në Gërdec të bëhej çmilitarizimi dhe çmontimi i municioneve. Kjo ishte në kundërshtim flagrant me nenin 3 të rregullores nr. 9603, datë 19.9.2003, të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas së cilës të gjitha aktivitetet në fushën e municioneve ushtarake duhej të kryheshin nga kompani të licencuara. Licenca duhet të lëshohet nga një komision i caktuar i krijuar nga ministri i Mbrojtjes. Kështu, çmontimi dhe çmilitarizimi i materialit në Gërdec u krye nga një kompani e palicencuar, Albademil sh.p.k., në kundërshtim me dispozitën e mësipërme.

Për më tepër, përcaktimi i Gërdecit si vendi i përshtatshëm për të ngritur objektin e çmilitarizimit të armëve u miratua pa kërkuar mendimin e autoriteteve përkatëse ushtarake, përkatësisht të Shtabit të Përgjithshëm. Gjithashtu, urdhri nr. 550 nuk përcaktonte autoritetin që do të siguronte mbikëqyrjen e procesit të çmilitarizimit në objekt.

Në fund, urdhri nr. 550 nuk përcaktonte se kush do të mbulonte shpenzimet e ngarkimit dhe transportimit të municioneve nga depoja e ushtrisë në Gërdec, por thjesht ia ngarkonte këtë Komandës së Forcave të Bashkuara. Urdhri nuk përmbante as masat e sigurisë të nevojshme për objektin e çmilitarizimit.

Hetimi tregoi, gjithashtu, se më 1 shtator 2007, SAC i kishte paraqitur një ofertë të dytë ministrit të Mbrojtjes për të vazhduar çmontimin e predhave 20 deri në 152 mm me gëzhoja tunxhi, pavarësisht se SAC kishte vetëm përvojë në çmontimin e municioneve të kalibrit të vogël. Në përgjigje të një kërkesë për informacion nga ministri i Mbrojtjes, SAC u përgjigj se kishte pajisjet e nevojshme për çmontimin e predhave të mëdha. Ministri i Mbrojtjes jo vetëm miratoi ofertën e dytë, por nxori edhe urdhrin nr. 1800, datë 22.10.2007, me të cilin pasuria nr. 126 (zona e Gërdecit) i kaloi MIECO-s, e cila më pas ia kaloi Albademil sh.p.k. pa kontratë qiraje, në kundërshtim me një vendim të mëparshëm të Këshillit të Ministrave.

Përveç kësaj, F.M. miratoi urdhrin. 2044, datë 7 dhjetor 2007 për transferimin e municioneve të MEICO, sipas të cilit procesi i çmontimit dhe çmilitarizimit u krye nga një kompani e palicencuar në një objekt të palicencuar. Në pikën 8 të urdhrin, MEICO-së iu besua mbikëqyrja e standardeve të sigurisë, masave të mbrojtjes nga zjarri dhe sigurisë së jetës dhe shëndetit të punonjësve në objekt. Ky parashikim nuk ishte në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, i cili përcaktonte se procesi i çmontimit dhe çmilitarizimit do të kryhej nën mbikëqyrjen dhe sigurinë e rreptë të forcave të armatosura.

Nga sa u tha më sipër, ka prova të mjaftueshme për të filluar ndjekjen penale të F.M.”

48. Më 16 qershor 2008, Kryetarja e Kuvendit nxori një vendim me të cilin autorizohet fillimi i procedimit penal ndaj F.M., deputet në atë kohë, sipas kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm.

C. Akt ekspertimi ushtarak i datës 10 shkurt 2009

49. Më 10 dhjetor 2008, një grup prokurorësh nga Prokuroria e Përgjithshme kërkuan ekspertim.

50. Më 10 shkurt 2009 pesë ekspertë të municioneve ushtarake hartuan një akt ekspertimi të detajuar. Në akt ekspertim thuhej se transporti nga depoja e armëve për në objektin e çmilitarizimit të armëve Gërdec ishte kryer me automjete të Forcave të Armatosura. Nuk kishte një grafik transporti, në kundërshtim me një urdhër të lëshuar nga ministri i Mbrojtjes.

51. Akt ekspertimi nuk mund të përcaktonte nëse objekti i çmilitarizimit të armëve në Gërdec kishte qenë një objekt ushtarak. Pas analizimit të akteve nënligjore, akt ekspertimi doli në përfundimin se zona e Gërdecit, e cila administrohej nga Ministria e Mbrojtjes, nuk ishte licencuar për t'u përdorur si depo municioni. Procesi i çmilitarizimit kishte mbartur një shkallë rreziku në

vetvete, pasi kishte konsistuar në ruajtjen e municioneve, çmontimin e tyre dhe ndarjen dhe ruajtjen e nënprodukteve. Prandaj, përcaktimi i objektit ushtarak të Gërdecit për qëllime çmilitarizimi duhet të shoqërohej me licencimin e magazinës dhe objekteve ku do të zhvilloheshin operacionet e çmilitarizimit. Kjo do të kërkonte një analizë të kapaciteteve të magazinimit dhe përpunimit nisur nga kushtet që ekzistonin në objekt.

52. Akti nuk nxori përfundime nëse masat e sigurisë ishin respektuar gjatë shkarkimit dhe marrjes së municioneve. Megjithatë, sipas akt ekspertimit municionet nuk ishin shkarkuar dhe ruajtur në magazina të veçanta, larg zonës së përdorur për operacionet e çmilitarizimit. Nuk kishte magazina të licencuara për ruajtjen e municioneve të dorëzuara nga forcat e armatosura. Më tej theksohej se sapo të lidhej kontrata e dytë me kontraktorin tregtar, duhet të ishin marrë një sërë masash përpara autorizimit të furnizimit me materiale dhe fillimit të punës. Disa nga masat duhej të përfshinin një inspektim paraprak të makinerive të çmontimit, respektimin e masave të sigurisë nga zjarri, vlerësimin e kualifikimeve dhe trajnimin e personelit, në lidhje me masat e sigurisë teknike dhe kapacitetin e magazinimit të kontraktorit. Autoriteti shtetëror përgjegjës nuk e kishte kryer këtë inspektim.

53. Sipas deklarimeve të punonjësve, raporti gjeti se personeli nuk kishte lexuar apo edhe parë ndonjë rregullore, në lidhje me masat e sigurisë teknike, as nuk ishte trajnuar përpara se të fillonte punën. Nuk ekzistonte ky informacion për periudhën pas lidhjes së kontratës së dytë më 28 dhjetor 2007.

54. Më tej akti konfirmoi se çmontimi i municionit nuk korrespondonte me çmontimin e tij siç ishte parashikuar në kontratë. Ai shtoi se infrastruktura e objektit nuk kishte përmbushur standardet e sigurisë për kryerjen e operacioneve të çmilitarizimit, të cilat ishin kryer në dy vende të hapura të pambrojtura nga ekspozimi ndaj rrezeve të diellit. Nuk kishte kontejnerë rezistent ndaj shpërthimit me të cilët mund të kryheshin operacione të rrezikshme. Teknologjia e përdorur për çmontimin nuk ishte e sigurt. Nuk ishte përdorur asnjë makineri dhe pajisjet nuk ishin në përputhje me kërkesat e sigurisë. Për sa i përket transportit në vend, mjetet e përdorura nuk kishin përmbushur masat e sigurisë të nevojshme për të punuar me materiale të rrezikshme. Objekti nuk ishte i pajisur me fikse zjarri apo sistem automatik spërkatës, as nuk ishte instaluar ndonjë sistem mbrojtjeje nga rrufeja.

55. Akti doli në përfundimin se forcat e armatosura supozohej të mbanin përgjegjësinë për sigurimin dhe mbrojtjen e objektit, ndërsa MEICO pritej të mbikëqyrte në përgjithësi aktivitetin e çmilitarizimit. Ai shtoi se nuk mund të përcaktohej me siguri se cili autoritet duhej të mbikëqyrte respektimin e masave të sigurisë gjatë procesit të çmilitarizimit.

D. Akt ekspertiza mjekoligjore

56. Më 18 mars 2008, policia kërkoi ekzaminimin mjekoligjor të Roxhens Durdajt (kërkuesi i parë në kërkesën nr. 46714/13). Qëllimi i ekzaminimit mjekoligjor ishte të vërtetohej ekzistenca e plagëve dhe shkakut të tyre. Akt ekspertiza mjekoligjore nr. 305, datë 2 prill 2008, tregoi se Roxhens Durdaj ishte plagosur rëndë, duke rezultuar në djegie të Kategorisë IIB-III 5% në të dy duart (*combustion mani bilateral*) dhe pjesën e pasme të kokës të shkaktuar nga flakët e shpërthimit. Raporti, gjithashtu, konkludoi se plagët ishin kërcënuese për jetën.

57. Më 11 gusht 2008, një prokuror i Prokurorisë së Rrethit Tiranë, urdhëroi ekspertizën pas vdekjes së trupit të Erison Durdajt (djali i kërkuesve në kërkesat nr. 12720/14 dhe 63543/09), që të kryhej nga eksperti mjekoligjor në Tiranë. Ekspertit iu kërkua të vërtetonte ekzistencën e ndonjë plage të jashtme, natyrën e tyre, mënyrën e shkakimit dhe shkakun e vdekjes. Ekspertit ju dha certifikata e vdekjes me dokumentet shoqëruese nga spitali Perrino në Brindisi të Italisë, ku ishte transferuar të nesërmen e aksidentit. Akt ekspertiza mjekoligjore nr. 805, datë 19 gusht 2008 deklaronte se më 15 mars 2008 në orën 13.00, Erison Durdaj ishte shtruar në reanimacionin e Qendrës Mjekësore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë, ku kishte marrë mjekim për djegie të

shkallës së dytë dhe të tretë që mbulonin 60% të trupit të tij. Ai kishte vuajtur nga dhimbje koke dhe veshi. Më 16 mars 2008 ishte transferuar në Spitalin Perrino në Brindisi, ku kishte vdekur më 3 prill 2008 në orën 2.50 të mëngjesit. Sipas certifikatës së vdekjes të lëshuar nga spitali, ai kishte vdekur nga komplikacione të djegieve të shkallës së dytë dhe të tretë që mbulonin 60% të trupit të tij të shkaktuara nga flakët e shpërthimit. Akt ekspertiza mjekoligjore konstatoi një lidhje shkakësore midis ngjarjes që kishte ndodhur dhe vdekjes së tij dhe si shkak të vdekjes u përcaktuar edema pulmonare akute pas shokut hipovolemik.

58. Certifikata mjekësore nr. 891, datë 5 shtator 2008, në lidhje me Alketa Hazizaj (kërkesja e dytë në kërkesën nr. 46714/13) konstatoi se ajo ishte plagosur rëndë me djegie në 35% të trupit të shkaktuara nga flakët e shpërthimit. Ekspertiza doli në përfundimin se plagët përbënin kërcënim për jetën.

59. Raportet mjekësore të të gjithë kërkesve në kërkesën nr. 46707/13 dolën në përfundimin se ata ishin plagosur rëndë si pasojë e shpërthimit në objekt. Gjykatës nuk i është dhënë një kopje e raporteve të tyre mjekësore. Konkluzionet e raporteve të tyre mjekësore u dorëzuan dhe u shqyrtuan në proceset e brendshme.

IV. PROCEDURA MBI AKUZËN

A. Gjykimi në Gjykatën e Lartë

60. Procedimi penal filloi për 30 persona të përfshirë në ngritjen dhe funksionimin e objektit të Gërdecit, përfshirë F.M., ish-ministër i Mbrojtjes dhe në atë kohë deputet. Procedimi penal u dërgua në Gjykatën e Lartë, sepse sipas nenit 141 § 1 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë kishte juridiksion fillestar për të shqyrtuar çështjet kundër deputetëve.

61. Më 6 mars 2009 Zamira Durdaj, Feruzan Durdaj, Roxhens Durdaj dhe palët e tjera të dëmtuara (jo kërkesit në rastin konkret) paraqitën padi civile në procesin penal sipas nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP") kundër tre prej të bashkakuarve (F.M., Y.P., dhe M.D.), kompanisë Albademil sh.p.k. dhe MEICO-s, dhe Kryeministrisë.

62. Më 13 mars 2009, Prokuroria e Përgjithshme formuloi akuzat kundër tridhjetë të akuzuarve:

F.M., ish-ministër i Mbrojtjes, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të Kodit Penal ("KP"); për prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit sipas nenit 278 të KP-së; dhe për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të Kodit Penal Ushtarak ("KPU");

Y.P., drejtuesi i MEICO-s, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së; për falsifikim të dokumenteve sipas nenit 186 § 2 të KP-së; për vrasje sipas nenit 79 të KP-së; për shkatërrimin e pronës me eksploziv sipas nenit 152 § 2, në lidhje me nenin 25 të KP-së; dhe për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të Kodit Penal Ushtarak ("KPU");

M.D., menaxher i Albademil sh.p.k., i akuzuar për vrasje sipas nenit 79 të KP-së; dhe për shkatërrimin e pronës me eksploziv sipas nenit 152 § 2, në lidhje me nenin 25 të KP-së;

D.M., menaxher objekti i Albademil sh.p.k., i akuzuar për vrasje sipas nenit 79 të KP-së; për shkatërrimin e pronës me eksploziv sipas nenit 152 § 2, në lidhje me nenin 25 të KP-së; për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së; dhe për prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit sipas nenit 278 të KP-së;

L.H., Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

S.N., punonjës në MEICO, i akuzuar për vrasje sipas nenit 79 të KP-së; dhe për shkatërrimin e pronës me eksploziv sipas nenit 152 § 2, në lidhje me nenin 25 të KP-së;

A.M., sekretar në Ministrinë e Mbrojtjes, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së;

Sh.M., Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së; për falsifikim të dokumenteve sipas nenit 186 §§ 2 dhe 3 të KP-së; për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

D.Ç., anëtar i Komisionit të Posaçëm të Kategorizimit të Pajisjeve të krijuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

A.T., Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes, Kryetar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

A.L., gjeneral i ushtrisë, Zëvendës Shef i Komandës së Përgjithshme, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

H.L., anëtar i Komisionit të Posaçëm të Kategorizimit të Pajisjeve të krijuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

N.M., Drejtor i Departamentit për Harmonizimin e Legjislacionit dhe Marrëdhënieve me Parlamentin në Ministrinë e Mbrojtjes, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së;

SH.S., komandant në forcat e armatosura, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

Z.B., komandant i Komandës Mbështetëse, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

A.B., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

R.T., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

B.D., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

F.K., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

G.O., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

J.M., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

D.H., anëtar i Komisionit për Miratimin e Çmimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

F.T., anëtar i Komisionit të Posaçëm për Kategorizimin e Pajisjeve të krijuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

Z.F., anëtar i Komisionit të Posaçëm për Kategorizimin e Pajisjeve të krijuar me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

H.Ç., anëtar i Komisionit të Posaçëm për Kategorizimin e Pajisjeve, të krijuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, i akuzuar për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak sipas nenit 2 dhe nenit 70 § 2 të KPU-së;

Ad.M., Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së;

Ju.M., Drejtor Finance në MEICO, i akuzuar për shpërdorim detyre sipas nenit 248 të KP-së;

L.Sh., Drejtor i Fabrikës së Municioneve Poliçan, i akuzuar për falsifikimin e dokumenteve sipas nenit 186 §§ 2 dhe 3 të KP-së;

Fi.M., Drejtor i Uzinës Mekanike Gramsh, i akuzuar për falsifikimin e dokumenteve sipas nenit 186 §§ 2 dhe 3 të KP-së; dhe

Albademil shpk, i akuzuar për vrasje sipas nenit 79 të KP-së dhe neneve 2, 3 dhe 4 të ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë ("LPPPJ"); për shkatërrimin e pronës me eksploziv sipas nenit 152 të KP-së dhe neneve 2, 3 dhe 4 të LPPPJ-së.

63. Në një datë të pacaktuar, disa prej të bashkakuzuarve kundërshtuan kompetencën e Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes së tyre.

64. Më 22 maj 2009, Gjykata e Lartë e veçoi procesin penal kundër F.M. nga proceset kundër të bashkakuzuarve të tjerë, duke pasur parasysh natyrën e ndryshme të akuzave kundër të bashkakuzuarve të tjerë dhe natyrën e bashkëpunimit mes tyre. Ajo u shpreh se në bazë të nenit 141 § 1 të Kushtetutës ishte kompetente për të shqyrtuar vetëm akuzat ndaj F.M. dhe i dërgoi çështjet ndaj të bashkakuzuarve të tjerë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

65. Po atë ditë, Gjykata e Lartë veçoi padinë civile të Zamira Durdaj, Feruzan Durdaj dhe Roxhens Durdaj nga procesi penal kundër të gjithë të bashkakuzuarve, përfshirë F.M., duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit penal, numrin e madh të bashkakuzuarve, fakti se një sërë veprash penale të pretenduara ishin kryer në bashkëpunim, humbjen e njëzet e gjashtë jetëve dhe dëmin ekonomik me përmasa të mëdha. Më tej, gjykata u shpreh se duke pasur parasysh numrin e madh të palëve të dëmtuara, për përcaktimin e dëmit pasuror dhe jopasuror kërkohej ekspertizë e specializuar, e cila do të merrej gjatë procesit civil. Ajo e ktheu padinë civile në një kolegji civil të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

66. Pasi iu dorëzua një kopje e vendimit të Gjykatës së Lartë, më 25 maj 2009, avokati i kërkuarve kërkoi që gjyqtari B.I. të tërhiqej nga shqyrtimi i çështjes për shkak se vajza e tij kishte qenë përfaqësuese e dy prej të bashkakuzuarve në një transaksion tregtar. Në të njëjtën datë, avokati i kërkuarve kërkoi që gjyqtarët E.S. dhe I.B. të tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes për shkak të pjesëmarrjes së tyre në trupin gjykues që kishte shqyrtuar disa nga kërkesat e prokurorit gjatë hetimit penal.

67. Më 17 qershor 2009 Zamira Durdaj, Feruzan Durdaj dhe Roxhens Durdaj paraqitën një ankim kushtetues kundër vendimit të Gjykatës së Lartë. Ata pretenduan se vendimi i Gjykatës së Lartë për të hequr dorë nga drejta e tyre për të marrë pjesë në procesin penal si palë civile përbënte shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë. Gjithashtu, ata pretenduan se Gjykata e Lartë nuk kishte shpjeguar pse shqyrtimi paralel i çështjes civile do të kishte vonuar procesin penal; kjo u kishte hequr atyre, gjithashtu, çdo mundësi për të marrë pjesë në gjykimin penal, për shembull, për të marrë

në pyetje dëshmitarët, për të paraqitur dokumentacion shtesë, për të kërkuar ekspertizë dhe thirrjen e dëshmitarëve, duke shkëlur në këtë mënyrë parimin e kontradiktoritetit në procesin gjyqësor.

68. Më 15 korrik 2009, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e tyre. Ajo konstatoi se Gjykata e Lartë kishte vepruar në përputhje, *inter alia*, me nenin 62 § 3 të KPP-së. Vendimi i saj ishte i ndërmjetëm dhe nuk mori në shqyrtim themelin e padisë civile. Ankimet nuk kishin të bënin me ndonjë shkelje të garancive kushtetuese për një gjykim të drejtë. Vendimi iu dorëzua avokatit të kërkuarve më 17 korrik 2009.

B. Procesi penal kundër njëzet e nëntë të akuzuarve

1. Gjyqi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

69. Procesi penal ndaj njëzet e nëntë të akuzuarve, përfshirë Albademil sh.p.k., vazhdoi më 11 qershor 2009 pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

70. Duket se në një datë të pacaktuar të vitit 2009, Gjykata e Rrethit Tiranë ka rrëzuar kërkesat e katër të bashkakuzuarve për zbatimin e *gjykimit të shkurtuar*.

71. Mbi 200 seanca u zhvilluan gjatë një periudhe prej tre vjetësh. Të paktën gjashtëdhjetë e dy dëshmitarë dhanë dëshminë e tyre, përfshirë disa nga kërkuarët, siç detajohet në paragrafët e mëposhtëm.

72. Feruzan Durdaj (kërkuar i dytë në kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14) dha dëshminë e tij më 7 dhjetor 2009. Ai u shpreh, *inter alia*, si vijon:

“Rreth mesditës më telefoni gruaja dhe më tha se i gjithë fshati Gërdec ishte në flakë. Ajo shtoi se nuk po e gjente djalin tonë, E.D. Kur mbërrita në Vorë, u përpoqa të shkoja në fshatin Gërdec, por gruaja, [që ishte] e shoqëruar me pesë a gjashtë fëmijë, më bindi që të shpëtoja fëmijët e mbetur dhe të mos shkoja atje. Kur mbërritëm në Tiranë, u përpoqa të gjeja djalin tim shtatëvjeçar. Sipas gruas, ai kishte shkuar me kushëririn e tij për t'i çuar drekën kunatës sime, së ndjerës Ra.Du. Më në fund e gjeta djalin, por nuk e njoha menjëherë për shkak të djegieve. Të nesërmen, më 16 mars 2008, unë dhe djali shkuam në një spital në Itali”.

73. Në seancën e mbajtur më 14 dhjetor 2009, Shaban Brahuhi (njëri nga kërkuarët në kërkesën nr. 46707/13) dha dëshminë e tij. Ai u shpreh, *inter alia*, si vijon:

“Nuk pashë asnjë pajisje tjetër përveç bllokut të çimentos që përdorej për çmontimin e predhave. Nuk kisha kontratë pune apo mbulim të sigurimeve shoqërore. Nuk më ka ndihmuar ndonjë ekspert dhe as nuk jam trajnuar. Nuk kisha dijeni për kompaninë amerikane dhe nuk kisha çmontuar kurrë më parë municione”.

74. Në seancën e mbajtur më 18 janar 2010, dëshmuar Alketa Hazizaj (kërkuar e dytë në kërkesën nr. 46714/13) dhe Rabie Gërdeci (njëra nga kërkuarët në kërkesën nr. 46707/13). Alketa Hazizaj deklaroi *inter alia*, si vijon:

“Kam punuar për [kohëzgjatjen e dy kontratave të lidhura nga SAC] me burrin, vjehrrin dhe kunatin tim. Nuk kemi nënshkruar asnjë kontratë dhe nuk ka pasur rregulla për sigurinë teknike. Udhëzimet për punën jepeshin nga drejtori. Ne ishim në dijeni se M.D. dhe D.M. ishin pronarë të objektit. Ne nuk dinim se çfarë të bënim në rast zjarri dhe nuk u dhanë udhëzime në këtë drejtim. Norma ditore e punës ishte shumë e lartë, por ne u përpoqëm ta përballonim ... pasi kishim nevojë. Asnjëherë nuk jemi ankuar për normën ditore të punës pasi kishim frikë se do të na pushonim nga puna”.

Rabie Gërdeci u shpreh *inter alia*, si vijon:

“Kam punuar pa kontratë bashkë me bashkëshortin në objekt. Ne nënshkruam një fletë të bardhë dhe morëm udhëzime nga D.M., menaxheri i objektit. E di që shefi i madh ishte M.D., të cilin e shihja herë pas here në objekt. Gjatë ekzekutimit të kontratës së parë ka pasur makineri për çmontimin e municioneve, gjë që nuk ka ndodhur për kontratën e dytë. Norma ditore e punës ishte e lartë. Burri im u ankua për normën ditore të punës të D.M. dhe më pas u pushua nga puna”.

75. Në seancën e mbajtur më 29 janar 2010, Dylbere Prini (një nga kërkuarët në kërkesën nr. 46707/13) dha dëshminë e saj. Ajo deklaroi *inter alia*, si vijon:

“Kam punuar në objektin e çmilitarizimit të armëve në vitin 2007 së bashku me vajzat e mia, Blertën dhe Artën, të cilat ishin përkatësisht 17 dhe 16 vjeç. D.M. shpjegoi rregullat, na ndau në grupe dhe na dha detyrat. Ndonjëherë anëtarë të grupit më i madh i grupit tonë, Vangjeli, na jepte udhëzime.”

76. Në seancën e mbajtur më 29 janar 2010, Mirela Hazizaj (një nga kërkueset në kërkesën nr. 46707/13) dha dëshminë e saj. Ajo deklaroi *inter alia*, si vijon:

“Kam punuar në objekt pa kontratë. Unë nuk kam pasur përvojë pune me municionet më përpara dhe askush nuk na udhëzonte se çfarë të bënim. Nuk kishte rregulla. Norma ditore e punës ishte vendosur nga drejtori. Nuk pashë asnjë pajisje për përdorim në rast zjarri dhe nuk ishin dhënë udhëzime [se çfarë duhej bërë në një ngjarje të tillë]. Nuk u dhanë rregulla për sigurinë teknike.”

77. Më 12 mars 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë miratoi një vendim të shkallës së parë, i cili kishte mbi 573 faqe.

Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli të pafajshëm nëntë nga të akuzuarit (A.M., A.L., Z.B., A.B., R.T., B.D., A.M., J.M. dhe Fi.M.). Në lidhje me SH.L., çështja u kthye në prokurori.

Gjykata e Rrethit Tiranë dënoi nëntëmbëdhjetë nga të akuzuarit dhe i dënoi me gjobë, me kusht ose burg nga tre deri në tetëmbëdhjetë vjet. Gjykata aplikoi një dënim të përgjithshëm për secilin nga të akuzuarit, të llogaritur në bazë të veprave të kryera njëkohësisht ose në mënyrë të njëpasnjëshme, i cili varioonte mes shumëve të të gjitha dënimeve individuale dhe dënimin më të rëndë.

Y.P. u shpall fajtor për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, shkatërrim prone nga pakujdesia dhe shpërdorim detyre në bashkëpunim me strukturën komanduese ushtarake. Ai u dënua me tetëmbëdhjetë vjet burgim.

M.D. u shpall fajtor për shkelje të rregullave për lëndët shpërthyesë, ndezëse ose radioaktive dhe u dënua me dhjetë vjet burgim; atij i është ndaluar edhe mbajtja e funksioneve publike për një periudhë pesëvjeçare.

D.M. u shpall fajtor për shkelje të rregullave të sigurisë në punë, shkatërrim të pronës nga pakujdesia dhe prodhim e mbajtje pa leje të armëve dhe municionit dhe u dënua me tetëmbëdhjetë vjet burgim.

L.H. u shpall fajtor për shpërdorim detyre sipas nenit 70 § 2 të KPU-së dhe u dënua me gjashtë vjet burgim. Gjithashtu, atij iu ndalua të ushtronte funksione publike për një periudhë katërvjeçare.

S.N. u shpall fajtor për veprën penale të shkeljes së rregullave të sigurisë në punë dhe shkatërrimit të pronës nga pakujdesia dhe u dënua me dhjetë vjet burgim.

Të akuzuarit e mëposhtëm u shpallën fajtorë sipas akuzës (shihni paragrafin 62 më lart): Sh.M. (dënuar me tre vjet burgim); D.Ç. (dënuar me tre vjet burgim); A.T. (dënuar me një vit burgim); H.L. (dënuar me tre vjet burgim); N.M. (dënuar me një vit burgim); SH.S. (dënim me kusht); F.K. (dënuar me një vit burgim); G.O. (dënuar me tre vjet burgim); J.M. (dënuar me tre vjet burgim); D.H. (dënuar me një vit burgim); F.T. (dënuar me tre vjet burgim); Z.F. (dënuar me tre vjet burgim); dhe H.Ç. (dënuar me tre vjet burgim).

Albademil sh.p.k. u dënua me 25 000 000 lekë gjobë dhe iu ndaluar përgjithmonë pjesëmarrja në prokurime publike dhe përfshirja në çdo aktivitet që lidhet me municionet për një periudhë dhjetëvjeçare.

78. Gjykata e Rrethit Tiranë vërtetoi faktet e çështjes si më poshtë.

Gjatë periudhës së kontratës së parë, procesi i çmontimit, për të cilin kishin dhënë ndihmë ekspertët amerikanë, kishte si objekt municionet e kalibrit të vogël (7.62, 8, 12.7 dhe 14.5 mm). Në periudhën e kontratës së dytë, asnjë ekspert amerikan nuk kishte qenë i pranishëm dhe çmilitarizimi përfshinte edhe municione të rënda të kalibrit nga 20 deri në 152 mm. Municioni ishte transportuar me mjete ushtarake dhe ishte shkarkuar ambient të hapur, i pambrojtur nga ekspozimi ndaj diellit dhe shiut. Kutitë e municioneve nuk ishin ruajtur në magazina të licencuara posaçërisht, larg zonës së çmilitarizimit.

Gjatë periudhës së kontratës së dytë, punonjësit ishin punësuar pa marrë parasysh moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore, kualifikimet apo njohuritë për procesin e nxjerrjes nga përdorimi apo municionet. Sipas dëshmive të dëshmitarëve, fëmijët e moshës tetë apo nëntë vjeç i kishin ndihmuar prindërit e tyre me punën e tyre të përditshme. Të paktën dhjetë të mitur, nga mosha 14 deri në 17

vjeç, kishin dëshmuar se ishin punësuar për të punuar në objektin e çmilitarizimit. Disa nga kërkuesit (kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14) deklaruan në dëshminë e tyre se djali i tyre shtatëvjeçar nuk kishte punuar kurrë në objekt, por ditën e ngjarjes po i çonte ushqimin njëerës prej të afërmeve të tij që punonte atje.

Gjatë gjithë procesit, punonjësit nuk ishin trajnuar për punën që duhej të kryenin, as nuk ishte kryer ndonjë trajnim tjetër, në lidhje me evakuimin në rast zjarri. Punonjësit nuk ishin informuar për ndonjë rregullore të sigurisë teknike në punën e tyre me eksplozivët, lëndët ndezëse dhe detonatorët, as nuk kishte pasur ndonjë rregullore të sigurisë teknike gjatë procesit të çmontimit. Në fakt, aty nuk kishte pasur makineri të duhura për çmilitarizimin e municioneve gjatë periudhës së kontratës së dytë.

Edhe pse kishte disa fiksë zjarri me presion të lartë, nuk ishte kryer asnjë trajnim, në lidhje me përdorimin e tyre, as nuk ekzistonte një sistem automatik spërkatës. Gjatë periudhës së kontratës së parë, zjarri kishte rënë në disa zona, por ai ishte shuar falë ndërhyrjes së punonjësve dhe disa specialistëve amerikanë. Nga zjarret nuk pati dëme serioze.

Sipas vendimit, deri më 26 dhjetor 2007 (në periudhën e kontratës së dytë), forcat e armatosura nuk kishin mundur të siguronin mbrojtjen e objektit, sepse me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes, pronësia i ishte kaluar MEICO-s, i cili ishte bërë kështu përgjegjës për sigurimin e objektit.

79. Të gjithë të pandehurit e ankimuan vendimin e shkallës së parë.

2. Zhvillime të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese

80. Më 26 mars 2012, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 14, që nuk kishte lidhje me rastin në fjalë, u shpreh se gjykimi i shkurtuar përmirësonte efikasitetin gjyqësor. Më tej iu referua vendimit nr. 2/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili konstatonte se gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mos aplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

3. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë

81. Më 13 shkurt 2013, pas ankimit nga prokuroria dhe të akuzuarve që ishin shpallur fajtorë nga Gjykata e Rrethit Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë miratoi një vendim, me 546 faqe, ku vendosi si më poshtë.

82. Mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 26 mars 2012, ajo zbatoi gjykimin e shkurtuar për katër nga të akuzuarit (Y.P., M.D., D.M. dhe Albademil sh.p.k), të cilët kishin ankimuar vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës së Rrethit që refuzonte kërkesën e tyre për zbatimin e gjykimit të shkurtuar. Zbatimi i gjykimit të shkurtuar sjell automatikisht uljen e dënimit me një të tretën.

83. Për sa i përket Y.P, Gjykata e Apelit Tiranë e shpalli të pafajshëm për veprat penale të shkeljes së rregullave të sigurisë në punë dhe shkatërrimit të pronës, sepse akuzat për këto vepra nuk ishin të mbështetura në prova, por e shpalli fajtor për shkeljen e rregullave për lëndët shpërthyesë, ndezëse ose radioaktive dhe për shpërdorimin e detyrës, dhe e uli dënimin e tij në dhjetë vjet burg. Gjykata e Apelit vlerësoi se dënimi i tij për shkelje të rregullave, në lidhje me përdorimin, prodhimin, ruajtjen, transportin dhe shitjen e lëndëve shpërthyesë ose ndezëse kishte rezultuar në vdekjen dhe plagosjen e rëndë të të tjerëve dhe ishte cilësuar krim i rëndë.

84. Për D.M., Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin që e shpallte fajtor për veprat penale të shkeljes së rregullave të sigurisë në punë dhe shkatërrimit të pronës, por pushoi procedimin penal për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve, dhe e uli dënimin në dymbëdhjetë vjet burg. Gjykata e Apelit vlerësoi se veprimet e tij kishin rezultuar në vdekjen dhe plagosjen e njerëzve që punonin në objektin e Gërdecit dhe përreth.

85. Për sa i përket M.D., Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin që e shpallte fajtor për veprën penale të shkeljes së rregullave për lëndët shpërthyesë, ndezëse ose radioaktive dhe e uli dënimin në gjashtë vjet e nëntë muaj burg. Gjykata e Apelit vlerësoi se veprimet ose mosveprimet e tij kishin shkaktuar vdekjen e 26 personave dhe plagosjen e rëndë të 27 personave, plagosjen më pak të rëndë të 109 personave, plagosjen e 67 personave dhe nevojën për trajtim mjekësor të 61 personave.

86. Vendimi i fajësisë u la në fuqi për Albademil sh.p.k., por gjoja e vendosur nga Gjykata e Rrethit Tiranë u ul me një të tretën, për shkak të gjykimit të shkurtuar.

87. Vendimi i fajësisë u la në fuqi dhe dënimet nuk ndryshuan për personat e mëposhtëm: S.N. (dhjetë vjet burg); L.H. (gjashtë vjet burg); dhe D.Ç., G.O., J.M., F.T., Z.F. dhe H.Ç (tre vjet burg). Për sa i përket S.N., Gjykata e Apelit Tiranë u shpreh se Gjykata e Rrethit Tiranë kishte konstatuar se ai kishte qenë personi përgjegjës për mbikëqyrjen e rreptë të rregullave për lëndët shpërthyesë, ndezëse ose radioaktive, gjë që ai nuk e kishte bërë, duke shkaktuar vdekjen dhe plagosjen e rëndë të tjerëve, që u cilësua si krim i rëndë.

Për L.H., Gjykata e Apelit u shpreh se, si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ai kishte qenë në dijeni se teknologjia që përdorej për çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve të kalibrit të vogël nuk ishte e përshtatshme, gjë që në veçanërisht rriste nivelin e rrezikut të qenësishëm në atë proces dhe mbartte pasojat e jashtëzakonshme.

88. Në lidhje me H.L. dhe SH.M., Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e tyre të fajësisë, por ua ndryshoi dënimin me një vit burg në tre vjet dënim me kusht.

89. Në lidhje me B.D., Z.B., R.T. dhe A.B., Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e tyre të pafajësisë, i shpalli ata fajtorë sipas akuzës dhe i dënoi me një vit burg të pezulluar për tre vjet dënim me kusht. Ata, gjithashtu, u ndaluan të ushtronin funksione publike për tre vjet.

90. Në lidhje me SH.S., Gjykata e Apelit e ndryshoi vendimin e tij të fajësisë dhe e shpalli të pafajshëm.

91. Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e pafajësisë për pesë nga të akuzuarit (A.M., A.L., Ad.M., Ju.M. dhe Fi.M.).

92. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë për kthimin e çështjes në prokurori, në lidhje me L.SH. u la në fuqi.

4. Vendimi i Gjykatës së Lartë

93. Pas ankimit të prokurorisë dhe të akuzuarve Y.P., S.N., M.D., D.M., SH.M., D.Ç., A.T., L.H., N.M., Z.B., A.B., R.T., B.D., F.K., G.O., J.M., D.H. dhe Albademil sh.p.k., më 19 korrik 2013, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

94. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk iu njoftua kërkuësve. Ata paraqitën artikuj gazetalesh të 29 korrikut 2013 që tregonin rezultatin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Sipas artikujve të gazetave teksti i plotë i vendimit do të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës së Lartë në një datë të mëvonshme.

95. Y.P. dhe J.M. depozituan një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për prishjen e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë. Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën më 26 nëntor 2015.

5. Ujta vijuese e dënimeve

96. Më 3 mars 2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë mori vendim për lirimin me kusht të Y.P. me kusht që për një periudhë tre vjeçare të mos kryente vepër tjetër penale.

97. Më 18 mars 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë e uli dënimin e M.D. me shtatëdhjetë ditë. Ai u lirua nga burgu më 21 mars 2013 për shkak të sjelljes së tij shembullore në burg.

98. Më 21 prill 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e uli dënimin e S.N. me nëntëdhjetë ditë për shkak të pendesës që ai kishte shfaqur. Sipas ligjit të ri nr. 22/2014 për dhënien e amnistisë ai përfitoi një vit ulje të dënimit.

99. Më 12 mars 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë mori një vendim për lirim me kusht të D.M.

C. Procesi penal dhe civil kundër F.M.

100. Pasi Gjykata e Lartë kishte veçuar më 22 maj 2009 (shihni paragrafin 64 më lart), procesin penal kundër F.M. nga proceset penale kundër njëzet e nëntë të akuzuarve të tjerë, procesi kundër F.M vazhdoi përpara Gjykatës së Lartë.

101. Më 1 gusht 2009 F.M u rizgjodh deputet.

102. Më 14 shtator 2009, Gjykata e Lartë, me shumicën me tri vota kundër dy votave, ndërpreu procesin kundër F.M për shkak të imunitetit të tij parlamentar, sepse prokurori nuk kishte kërkuar autorizim të ri pas rizgjedhjes së tij.

1. Ndjekja penale me kërkesë të Roxhens Durdaj dhe Alketa Hazizaj

103. Në një datë të pacaktuar në vitin 2009 Roxhens Durdaj dhe Alketa Hazizaj, në cilësinë e palëve të dëmtuara, kërkuan ndjekjen penale kundër F.M në Gjykatën e Lartë për plagosje të rëndë nga pakujdesia sipas nenit 91 të KP.

104. Më 1 mars 2010, Gjykata e Lartë vendosi mosfillimin e procedimit penal kundër F.M, duke konstatuar mungesën e elementëve të figurës së veprës penale (*mens rea* dhe *actus reus*). Më tej, ajo u shpreh se kërkuesit Roxhens Durdaj dhe Alketa Hazizaj nuk kishin arritur të provonin se ishin plagosur rëndë si pasojë e ngjarjes së Gërdecit. Roxhens Durdaj dhe Alketa Hazizaj kanë bërë ankim kushtetues kundër këtij vendimi.

105. Më 9 maj 2012, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 1 mars 2010, duke konstatuar se *inter alia* Gjykata e Lartë, duke vendosur mosfillim procedim penal, kishte marrë atributet e prokurorisë dhe kishte tejkaluar kompetencën e saj. Ajo e ktheu çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

106. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata e Lartë vendosi të pushojë gjykimin kundër F.M. për shkak të ligjit për dhënie amnistie të vitit 2012. Ky vendim kishte të bënte vetëm me akuzat sipas nenit 91 të KP për plagosje të rëndë nga pakujdesia.

2. Procedimi i filluar nga Shoqata

107. Më 14 janar 2010, Shoqata e familjeve të viktimave të shpërthimit të Gërdecit (“Shoqata”), me anëtarë të gjithë kërkuesit, i kërkoi prokurorit fillimit e procedimit penal kundër F.M.

108. Duke mos marrë përgjigje për kërkesën e saj, Shoqata depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë më 21 janar 2011 dhe më 2 maj 2011 Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi se nuk ishte kompetente për të shqyrtuar padinë civile të Shoqatës. Pas ankimit nga Shoqata, më 13 qershor 2011, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin, duke vlerësuar se Shoqata nuk mund të konsiderohej “palë e dëmtuar” sipas kuptimit të nenit 58 të KPP-së dhe për këtë arsye ajo nuk kishte locus standi. Sipas vendimit, vetëm një person mund të konsiderohej palë e dëmtuar.

3. Ndjekja penale me kërkesë të Aishe Selami, Rabije Gërdeci, Dylbere Prini dhe Bege Aliu

109. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2011, të gjithë kërkuesit, në cilësinë e palëve të dëmtuara, kërkuan përpara Gjykatës së Rrethit Tiranë procedimin penal të F.M për nenin 91 të K.P. dhe kundër gjashtë prej të akuzuarve të tjerë për plagosje të rëndë nga pakujdesia. Ata kërkuan edhe dëmshpërblim. Duke pasur parasysh faktin se F.M. ishte deputet, më 25 prill 2011 Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli moskompetencë për vazhdimin e gjyimit dhe ia kaloi dosjen Gjykatës së Lartë, e cila më 23 janar 2012 vendosi vazhdimin e gjyimit, vetëm në lidhje me kërkuesit Aishe Selami, Rabije Gërdeci, Dylbere Prini dhe Bege Aliu, sepse kërkuesit e tjerë nuk e kishin nënshkruar padinë apo nuk ishin paraqitur personalisht përpara gjykatës.

110. Më 24 janar 2012, Gjykata e Lartë vendosi mosfillimin e çështjes penale kundër F.M. të kërkuar nga Aishe Selami, Rabije Gërdeci, Dylbere Prini dhe Bege Aliu, duke konstatuar mungesën e elementëve të figurës së veprës penale (*mens rea* dhe *actus reus*). Ajo e veçoi procedimin ndaj të bashkakuzuarve të mbetur dhe e ktheu çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

111. Më 8 nëntor 2012 u miratua ligji për dhënie amnistie (shihni paragrafin 155 më poshtë).

112. Më 26 tetor 2012 hyri në fuqi një ndryshim i Kushtetutës së Shqipërisë, sipas të cilit nuk kërkohej më autorizimi i Kuvendit për fillimin e procedimit penal ndaj një deputeti. Si rezultat, kërkesit depozituan një kërkesë në Prokurorinë e Përgjithshme për fillimin e procedimit penal kundër F.M.

4. Procedimi penal i filluar me kërkesë të Feruzan Durdajt dhe Zamira Durdajt

113. Më 25 prill 2013, në një intervistë televizive për Zërin e Amerikës, Prokurori i Përgjithshëm deklaroi se nuk do të fillonte procedim penal ndaj F.M nëse nuk do të kishte fakte të reja. Sipas tij, kërkesit dhe viktimat e tjera nuk kishin paraqitur fakte të reja përveç atyre të hetuara tashmë.

114. Më 26 shkurt 2021, Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj paraqitën kërkesë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të filluar procedimin penal kundër F.M. Pas kësaj kërkesë, më 5 maj 2021, ky organ paraqiti kërkesën e tyre në Gjykatën e Lartë duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të saj të 14 shtatorit 2009 për mosfillimin e procedimit penal ndaj F.M (shih paragrafin 102 më lart).

115. Më 1 qershor 2021, kolegji penal i Gjykatës së Lartë shpalli moskompetencë për të vendosur mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme dhe e kaloi çështjen në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

116. Më 27 korrik 2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar refuzoi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme.

117. Më 2 gusht dhe 10 gusht 2021, përkatësisht, Prokuroria e Posaçme dhe Feruzan Durdaj dhe Zamira Durdaj paraqitën ankim kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

118. Më 24 shtator 2021, Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar prishi vendimin e datës 27 korrik 2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, miratoi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2009 për mosfillim gjykimi penal kundër F.M dhe dërgoi çështjen për procedim të mëtejshëm në Prokurorinë e Posaçme.

119. Më 1 tetor 2021, F.M depozitoi një ankim kushtetues ku kërkonte shfuqizimin e vendimit të 1 qershorit 2021 të kolegjit penal të Gjykatës së Lartë (shihni paragrafin 116 më lart). Gjykata Kushtetuese e refuzoi ankimin më 13 dhjetor 2021.

120. Më 1 nëntor 2021, F.M paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të 24 shtatorit 2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (shihni paragrafin 118 më lart), i cili u rrëzua më 21 dhjetor 2021. Gjykata e Lartë *inter alia* vlerësoi se Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kishte zbatuar drejt ligjin material dhe procedural dhe kishte adresuar në mënyrën adekuate të gjitha pretendimet e ngritura në ankimin e F.M.

121. Më 11 janar 2023, Prokuroria e Posaçme i njoftoi kërkesit për vendimin e saj për vazhdimin e procedimit ndaj F.M vetëm për akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe për mbylljen e hetimit ndaj F.M për akuzat tjera. Kërkesit me anë të një shkrese drejtuar Prokurorisë së Posaçme më 23 janar 2023 kërkuan ndjekjen penale të F.M edhe për vrasje në rrethana rënduese ose shkelje të rregullave të sigurisë në punë.

122. Në janar të vitit 2023, Prokuroria e Posaçme e akuzoi F.M. për shpërdorim detyre të kryer vetë dhe në bashkëpunim me zinxhirin komandues të Forcave të Armatosura dhe punonjës të tjerë civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe e dërgoi çështjen për gjykim më 8 shkurt 2023. Ky proces është aktualisht në pritje përpara Gjykatës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar.

123. Më 28 janar 2023, Prokuroria e Posaçme iu përgjigj kërkuësve që argumentet e tyre për ricilësimin e veprave penale ndaj F.M nuk mund të pranoheshin.

V. PROCESIT ADMINISTRATIVE

A. Kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14

124. Në një datë të pacaktuar, Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj depozituan një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Ministrisë së Mbrojtjes, Këshillit të Ministrave, MEICO-s dhe Albademil sh.p.k. Mbështetur në Kushtetutë (pa iu referuar ndonjë dispozite të veçantë), Konventë (pa iu referuar ndonjë dispozite të veçantë), nenet 608 dhe 626 të Kodit Civil, ligjin nr. 8510, datë 15.7.1999, për përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të administratës shtetërore (pa iu referuar ndonjë dispozite të veçantë), ligjin nr. 8485, datë 12 maj 1999 për kodin e procedurave administrative (pa iu referuar ndonjë dispozite të veçantë), dhe ligjin nr. 9000, datë 30 janar 2003 për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave (pa iu referuar ndonjë dispozite të veçantë), ata kërkuan dëmshpërblim për vdekjen e djalit të tyre të shkaktuar nga ngjarja e Gërdecit. Ata pretenduan se kishin pësuar dëmtime të rënda në shëndetin, personalitetin dhe jetën e tyre familjare. Ata kërkuan dëmshpërblim si për dëmin pasuror ashtu edhe atë jopasuror për shkak të vuajtjes mendore, pasojave që kishin në lidhje me shëndetin, jetën familjare dhe private, humbjen e mundshme të të ardhurave të familjes së tyre, shpenzimet e varrimit, shërbimet shëndetësore dhe trajtimet e anëtarëve të traumatizuar të familjes. Procesit ju bashkuan Iva Durdaj dhe Geraldo Durdaj, vëllai dhe motra e viktimës.

125. Me vendimin nr. 1549, datë 26 mars 2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pranoi pjesërisht padinë e kërkuësve. Ajo urdhëroi Ministrinë e Mbrojtjes, MEICO-n dhe Albademil sh.p.k. t'i paguanin secilit kërkuës 8,699,381 lekë (rreth 60,900 euro (EUR) në atë kohë) për dëmin pasuror dhe jopasuror, dëmin biologjik, psikologjik dhe ekzistencial për humbjen e djalit të tyre shtatëvjeçar dhe 7,421,601 lekë për secilin vëllanë e motrën e viktimës (rreth 51,950 euro në atë kohë).

126. Gjykata Administrative vlerësoi se Ministria e Mbrojtjes dhe MEICO, një kompani shtetërore nën autoritetin e ministrit/Ministrisë së Mbrojtjes, ishin përgjegjëse për pasojat e tragjedisë, sepse ato e kishin ngritur objektin e Gërdecit dhe nuk kishin marrë masat e duhura parandaluese për të shmangur ngjarjen që u kishte shkaktuar dëm kërkuësve.

127. Gjykata Administrative rrëzoi argumentet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe MEICO-s se pretendimi i kërkuësve ishte parashkuar dhe se Ministria nuk kishte legjitimim pasiv në proces. Gjykata u shpreh se Ministria e Mbrojtjes kishte qenë në dijeni të natyrës së rrezikshme të aktivitetit të çmilitarizimit dhe se ky aktivitet duhej të ishte kryer sipas standardeve të "sigurisë ushtarake". Megjithatë, këto standarde nuk ishin respektuar. Ministria kishte dështuar në detyrën e saj për të kryer mbikëqyrjen e aktiviteteve në objektin e Gërdecit, veçanërisht për shkak se kjo drejtohej nga një kompani shtetërore, përkatësisht MEICO, nën autoritetin e ministrit të Mbrojtjes dhe kompania nuk kishte specializimin e duhur për të ofruar standarde të sigurisë ushtarake.

128. Gjykata Administrative, referuar vendimit nr. 381, datë 12.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të marrë në procesin penal ndaj të akuzuarit, në lidhje me tragjedinë, dhe të konfirmuar me vendimin nr. 138, datë 13 shkurt 2013, të Gjykatës së Apelit, u shpreh se përgjegjësia subjektive e ministrit të Mbrojtjes buronte nga mosveprimi i tij për të angazhuar forcat e armatosura për të mbikëqyrur aktivitetet e rrezikshme; dhe se ministri kishte vepruar përtej autorizimit të dhënë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 14.3.2007, kur kishte nxjerrë urdhrin nr. 2044,

datë 7 dhjetor 2007, për çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve. Gjithashtu, Gjykata Administrative shpalli përgjegjës ministrin e Mbrojtjes për faktin se ai kishte urdhëruar kryerjen e aktivitetit në një vend të pa licencuar për ruajtjen e municioneve, si dhe për autorizimin e kompanive të palicencuara për të operuar teknologjitë e çmilitarizimit.

129. Më tej, Gjykata Administrative u shpreh se përgjegjësia objektive e ministrit të Mbrojtjes buronte nga fakti që ai nuk kishte ndërmarrë veprime të arsyeshme për të shmangur ose për të ulur rrezikun kërcënues ndaj jetës nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarive të rrezikshme. Në lidhje me këtë, gjykata u mbështet në nenin 622 të Kodit Civil, duke konstatuar se autoritetet shtetërore dhe personat e autorizuar prej tyre kishin përgjegjësi të rreptë dhe në asnjë rrethanë dhe as me ndonjë ligj në fuqi, një autoritet ose organ shtetëror i autorizuar prej tyre nuk mund të shmangte “përgjegjësinë jashtëkontraktuale” dhe detyrimin për të licencuar dhe mbikëqyrur veprimtaritë e rrezikshme. Gjykata Administrative është mbështetur edhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 14.3.2007, duke konstatuar se sipas këtij vendimi procedura e çmontimit duhej të ishte kryer nën mbikëqyrjen e Forcave të Armatosura dhe se urdhrat nr. 550 e datës 25 prill 2007 dhe 2044 e datës 7 dhjetor 2007, të dy të nxjerrë nga ministri i Mbrojtjes, nuk ishin në përputhje me dispozitat dhe kufizimet e parashikuara në vendimin e mësipërm të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes, si zyrtari më i lartë i forcave të armatosura në atë kohë, kishte qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e procedurës së çmontimit.

130. Gjykata Administrative konstatoi se aktivitetet e rrezikshme që po kryheshin në objektin e Gërdecit kishin rezultuar në humbje jete dhe dëme të tjera të shkaktuara ndaj paditësve dhe se të drejtat e tyre legjitime ishin shkelur.

131. Gjykata Administrative u shpreh se autoritetet shtetërore kishin barrën për të provuar se kishin marrë të gjitha masat e mundshme dhe efektive për të shmangur ose parandaluar aksidentin dhe se ato nuk kishin arritur ta provonin këtë gjë. Gjykata Administrative, mbështetur në vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të marrë në procesin penal, u shpreh se të pandehurit nuk kishin marrë asnjë masë parandaluese për të garantuar respektimin e standardeve minimale të sigurisë; proceset e punës në objektin e Gërdec qenë kaotike dhe aktivitetet e çmilitarizimit ishin kryer në mungesë të licencave të kërkuara; punonjësit nuk kishin pasur trajnim të duhur për kryerjen e një pune të tillë; aktivitetet ishin kryer në kundërshtim me rregulloret teknike ushtarake; vendndodhja nuk plotësonte kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 14.3.2007; dhe ngritja e objektit të Gërdec dhe funksionimi i tij nuk ishte monitoruar apo mbikëqyrur nga autoritetet shtetërore përgjegjëse.

132. Gjykata rrëzoi pretendimet ndaj Këshillit të Ministrave si të pabazuara në ligj dhe të pambështetura në ndonjë provë.

133. Të pandehurit ankimuan vendimin e shkallës së parë dhe ky vendim u la në fuqi në apel më 24 maj 2017 nga Gjykata Administrative e Apelit.

134. Në një datë të pacaktuar, kërkuesit depozituan një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për dëmshpërblim për shkatërrimin e pronës së tyre nga shpërthimi.

135. Më 8 qershor 2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë pranoi pjesërisht padinë e kërkuesve për dëmshpërblim dhe u caktoi atyre 3 626 015 lekë dëmshpërblim për shkatërrimin e pronës së tyre të paluajtshme nga shpërthimi.

B. Kërkesa nr. 46707/13

136. Në një datë të pacaktuar, Sabrije Picari dhe familjarët e saj depozituan një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Ministrisë së Mbrojtjes, MEICO-s dhe Albademil sh.p.k. Ata kërkuan 30,000,000 lekë për dëmin pasuror dhe jopasuror, përfshirë dëmin e shkaktuar ndaj shëndetit, dëmin ekzistencial dhe moral, në lidhje me rrezikun për jetën e saj të shkaktuar nga shpërthimi në objektin e Gërdecit.

137. Më 26 mars 2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i caktoi Sabrije Picarit 11,049,837 lekë (rreth 77,300 euro në atë kohë) për dëmin pasuror, përfshirë dëmin shëndetësor, ekzistencial dhe moral (për shkak të humbjes së të ardhurave të saj, duke marrë duke marrë parasysh të ardhurat që ajo kishte fituar para aksidentit, shpenzimet mjekësore dhe farmaceutike dhe shpenzimet që lidhen me kujdesin e saj ditor nga persona të tretë); dhe 6 761 029 lekë (rreth 47 300 euro në atë kohë) për dëmin jopasuror.

138. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës Administrative përputhet me atë në çështjen e paraqitur nga Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj.

139. Në një datë të pacaktuar, G.K. dhe anëtarët e familjes së tij, të cilët nuk janë kërkuar përpara Gjykatës, depozituan një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Ministrisë së Mbrojtjes, MEICO-s, Albademil sh.p.k. dhe SAC. Ata pretenduan 19 000 000 lekë për dëmin pasuror dhe jopasuror, përfshirë dëmin shëndetësor, ekzistencial dhe moral. Më 30 dhjetor 2014, G.K u dëmshpërblye me 13 000 000 lekë.

KUADRI LIGJOR PËRKATËS DHE PRAKTIKA

I. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

140. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës parashikojnë si më poshtë:

Neni 21

“Jeta e personit mbrohet me ligj.

Neni 44

Kushdo ka të drejtë (...) të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Neni 141

1. Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

...”

141. Deri më 17 shtator 2012, sipas nenit 73 § 2 të Kushtetutës, kërkohej autorizimi i Kuvendit përpara fillimit të hetimit penal ndaj një deputeti.

142. Më 18 shtator 2012, neni 73 § 2 i Kushtetutës u ndryshua për të lejuar hetimin penal të një deputeti pa autorizimin paraprak të Kuvendit. Ky ndryshim hyri në fuqi më 26 tetor 2012.

B. Kodi i Procedurës Penale (“KPP”)

1. Pala e dëmtuar

143. Sipas nenit 58 të KPP-së, i dëmtuari që rezulton nga kryerja e një vepre penale ose trashëgimtarët e tij/saj kanë të drejtë të kërkojnë ndjekjen penale të fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. I dëmtuari ka të drejtë t’i bëjë kërkesa prokurorit dhe të kërkojë marrjen e provave.

144. Sipas nenit 61 ai që ka pësuar dëm pasuror nga vepra penale mund të ngrejë padi civile në procesin penal për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Sipas nenit 62 kërkesa duhet të dorëzohet përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në përputhje me nenin 62 § 3, një gjykatë mund të vendosë veçimin e padisë civile nga procesi penal nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

145. Neni 70 parashikon se vendimi penal i formës së prerë në procesin penal nëse është kryer vepra penale dhe nga kush është kryer është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës penale në fjalë.

2. Gjykimi i shkurtuar

146. Legjislacioni i brendshëm dhe praktika gjyqësore përkatëse, në lidhje me gjykimin e shkurtuar përshkruhen në *Cani kundër Shqipërisë*, nr. 11006/06, §§ 34–35, 6 mars 2012.

147. Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues nr. 2, datë 29 janar 2003 u shpreh, *inter alia*, se një gjykatë duhet të shfuqizojë vendimin e saj për zbatimin e gjykimit të shkurtuar nëse palët

ankohen për vërtetësinë e akteve ose dokumenteve juridike. Për rrjedhojë, duhet urdhëruar vazhdimi i shqyrtimit normal gjyqësor. Gjykata e Lartë, gjithashtu, vlerësoi se zbatimi i gjykimit të shkurtuar nuk mund të pranohej, në lidhje me një të pandehur i cili po gjykohej në një sërë procesesh të cilat përfshinin edhe bashkë të pandehur të tjerë që nuk kishin kërkuar gjykimin e shkurtuar. Vetëm kur lejohet ndarja e çështjeve në përputhje me ligjin – konkretisht sipas nenit 93 të KPP-së – mund të miratohet gjykimi i shkurtuar për të akuzuarin që ka kërkuar zbatimin e tij.

148. Më 26 mars 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi se vendimi i ndërmjetëm i dhënë nga një gjykatë rrethi, që refuzonte kërkesën e të akuzuarit për zbatimin e gjykimit të shkurtuar, mund të ankimohej në gjykatën e apelit. I akuzuari mund ta kundërshtonte vendimin e ndërmjetëm në të njëjtën kohë që ai ose ajo ankimon vendimin e dënimit të tij/saj në themel.

C. Kodi Penal (“KP”)

149. Dispozitat përkatëse të Kodit Penal lexojnë si më poshtë:

Neni 25

Kuptimi i bashkëpunimit

“Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre.”

Neni 79

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese

Vrasja me dashje e kryer:

...

ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.”

Neni 91

Plagosja e rëndë nga pakujdesia

“Plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”

Neni 248

Shpërdorimi i detyrës

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”

Neni 278

Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit

“Prodhimi i armëve dhe i municioneve luftarake, lëndëve plasëse, i bombave apo minave, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Mbajtja e municioneve luftarake, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Mbajtja e armëve në banesë, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Mbajtja e armëve, bombave apo minave, ose lëndëve plasëse në automjete në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra penale kryhet në sasi të mëdha, në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.”

D. Kodi Penal Ushtarak (“KPU”)

150. Neni 2 i KPU-së parashikon që zbatohet për shtetasit shqiptarë që kryejnë një veprë penale në fushën e mbrojtjes së shtetit.

151. Neni 70 i KPU-së përkufizon veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe lexon si më poshtë:

“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, për përmbushjen e rregullt të detyrës, kur i ka sjellë pasoja të rënda shtetit ose interesave të ligjshëm të shtetasve, dënohet me gjobë, nxjerrje në lirim ose me burgim deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër është kryer nga kuadri ose personeli komandues dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.”

E. Kodi Civil

152. Pjesa përkatëse e Kodit Civil parashikon:

“TITULLI IV

DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA SHKAKTIMI I DËMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

Neni 608

Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Personi që ka shkakuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

(...)

Neni 622

Përgjegjësia nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme

Personi që kryen një veprimtari të rrezikshme nga natyra e saj ose nga natyra e sendeve të përdorura dhe u shkakton dëm personave të tjerë, detyrohet të shpërblejë dëmin, përveç kur provon se ka përdorur të gjitha masat e përshtatshme e të nevojshme për mënjanimin e dëmit.”

F. Ligji nr. 8510 i 15 korrikut 1999 për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore

153. Neni 1 dhe 3 i ligjit (ndryshuar me ligjin nr. 10005 të 23 tetorit 2008) parashikon që organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizike a juridike, private, vendës a të huaj. Ato kanë detyrimin të shpërblejnë për dëmin që u shkaktojnë interesave të personave privatë në ushtrimin e funksioneve të tyre publike: i. kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme; ii. kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshëm të personave fizikë a juridikë privatë; iii. kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizikë a juridikë privatë cenohen në interesat e tyre të ligjshëm; iv. kur u shkaktojnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizikë a juridikë privatë; v. kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

G. Ligji për amnistinë

154. Ligji për amnistinë hyri në fuqi më 8 nëntor 2012 në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë. Sipas nenit 5 të ligjit për dhënie amnistie, ndjekja penale nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar tashmë duhet të pushohet në lidhje me ato vepra penale që janë kryer përpara 30 shtatorit 2012 dhe në lidhje me të cilat Kodi Penal parashikon dënimin deri në dy vjet burg ose dënim tjetër më të lehtë.

II. MATERIALI PËRKATËS I KËSHILLIT TË EVROPËS

155. Më 15 mars 2023, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin CM/Rec (2023)2 për të drejtat, shërbimet dhe mbështetjen për viktimat e krimit. Neni 10 i

rekomandimit trajton në termat e mëposhtëm të drejtën e viktimave për t'u dëgjuar në procesin penal kundër autorit të krimit:

“Neni 10 – E drejta për t'u dëgjuar

1. Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që viktimat të mund të dëgjoen dhe të sjellin prova gjatë procesit penal.

2. Shtetet Anëtare inkurajohen të lejojnë viktimat që të dëgjoen edhe gjatë proceseve pas gjykimit.

3. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, Shtetet Anëtare inkurajohen të lejojnë që dhënia e provave të bëhet me iniciativën e viktimës dhe të mos e kufizojnë këtë me detyrimin për të dëshmuar gjatë hetimit ose gjykimit.

4. Për aq sa është e mundur, dhe në përputhje me të drejtat e të pandehurit, Shtetet Anëtare inkurajohen të marrin parasysh disponueshmërinë e viktimave në planifikimin dhe shtyrjen e proceseve gjyqësore dhe pas gjykimit.

5. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, Shtetet Anëtare inkurajohen të sigurohen që e drejta për t'u dëgjuar të zbatohet për çdo vendim që mund të supozohet se ka ndikim të konsiderueshëm në interesat e viktimave. Ky inkurajim në veçanti mund të bëhet për:

a) çdo vendim në lidhje me dhënien e informacionit për dhe nga viktimat, duke përfshirë, *inter alia* të drejtën për përkthim me shkrim dhe me gojë;

b) çdo vendim për të mos zbatuar proceset e drejtësisë restauruese, në ato raste kur viktimat ka kërkuar zbatimin e tyre nëse gjen zbatim;

c) çdo vendim për të mos ndjekur penalisht autorin;

d) çdo vendim për t'u drejtuar formave të zgjidhjes jashtëgjyqësore nëse gjen zbatim;

e) çdo vendim në lidhje me dhënien e shpërblimit për viktimën gjatë ecurisë së procesit penal;

f) çdo vendim për të marrë shpërblim nga shteti;

g) çdo vendim në lidhje me mbrojtjen e viktimës.

6. Rregullat procedurale sipas të cilave viktimat mund të dëgjoen dhe mund të ofrojnë prova dhe masa në të cilën autoritetet duhet të marrin parasysh të drejtën e viktimës për t'u dëgjuar përcaktohen me legjislacionin kombëtar.”

LEGJISLACIONI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

156. Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e sheh të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

157. Kërkuesit u ankuan si për aspektin material ashtu edhe në atë procedural të nenit 2 të Konventës se Shteti ishte përgjegjës për shpërthimin në objektin e Gërdecit, ku mbetën të vrarë të afërmit e tyre ose ku kërkuesit pësuan plagë të rënda në trup dhe se hetimi për ngjarjen dhe proceset vijuese për aktakuzën nuk kishin përmbushur kërkesat e atij neni. Kërkuesit në kërkesat nr. 46707/13 dhe 46714/13, gjithashtu, u ankuan sipas nenit 13 të Konventës se ata nuk kishin pasur mjete juridike efektive për ankimin e tyre. Gjykata duke qenë kompetente për cilësimin me ligj të fakteve të një çështjeje, vlerëson se problemet e ngritura në këtë çështje duhet të shqyrtohen vetëm nga këndvështrimi i nenit 2 të Konventës (krahasoni *Jelić kundër Kroacisë*, nr. 57856/11, § § 107–09, 12 qershor 2014, dhe *M. dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 50175/12, § 52, 2 maj 2017).

158. Pjesa përkatëse e nenit 2 të Konventës lexon si më poshtë:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj...”

159. Gjykata vëren që në fillim se Qeveria nuk e kundërshtoi zbatueshmërinë e nenit 2 të Konventës. Nisur nga fakti që kërkuesit ishin të mbijetuarit e një shpërthimi municionesh ku morën plagë kërcënuese për jetën, neni 2 është i zbatueshëm (krahasoni, për shembull, *Vovk dhe Bogdanov kundër Rusisë*, nr. 15613/10, § 57, 11 shkurt 2020). Gjithashtu, nuk ka asnjë problem me zbatueshmërinë e nenit 2, në lidhje me kërkuesit që janë të afërmit e viktimave që u vranë nga shpërthimi në objektin e Gërdecit.

A. Aspekti procedural i nenit 2 të Konventës

1. Pranueshmëria

a) Parashtrimet e palëve

160. Qeveria parashtroi se kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14 ishin depozituar jashtë afatit 6-mujor, duke pasur parasysh se vendimi i Gjykatës së Lartë kishte marrë formë të prerë më 19 korrik 2013. Në lidhje me këtë, ata theksuan se nuk kishin dijeni se si ishin njoftuar kërkuesit për vendimin e Gjykatës së Lartë sepse sipas legjislacionit të brendshëm Gjykata e Lartë nuk kishte detyrim t'i njoftonte ata. Megjithatë, Qeveria u shpreh se, si rregull, vendimet e Gjykatës së Lartë publikoheshin në sistemin e brendshëm të ruajtjes së të dhënave dhe në faqen e saj të internetit brenda njëzet e katër orëve pas seancës.

161. Qeveria, gjithashtu, pretendoi se procesi penal ishte ende në pritje dhe për këtë arsye kërkesat ishin të parakohshme.

162. Kërkuesit në kërkesat nr. Kërkuesit në kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14 parashtuan se kishin marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë mbrëmjen e 29 korrikut 2013, data e publikimit të artikullit në internet. Kështu, data e fillimit për periudhën gjashtëmujore duhet të jetë ajo e 29 korrikut 2013, dhe për këtë arsye ata kishin përmbushur kushtin për të paraqitur kërkesën e tyre brenda gjashtë muajve nga data e vendimit përfundimtar në vend. Ata argumentuan se duke qenë se sipas legjislacionit të brendshëm Gjykata e Lartë nuk e kishte detyrimin për të njoftuar palët për vendimet e saj, periudha gjashtëmujore fillonte në momentin që ata kishin marrë dijeni për vendimin e saj.

163. Kërkuesit argumentuan se procedimi penal kishte qenë i vetmi mjet juridik efektiv në dispozicion të tyre si palë të dëmtuara. Ata pretenduan se procedimi penal që kishin nisur nuk ishte përfunduar për shkak të zbatimit të ligjit për amnistinë ndaj të akuzuarit. Kërkuesit parashtuan se në mungesë të ndonjë mjeti ligjor në dispozicion të tyre për të kundërshtuar efektet e ligjit për amnistinë, afati gjashtëmujor kishte filluar nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 7 të datës 10 dhjetor 2012 që pushonte procedimin penal për shkak të ligjit për amnistinë. Ata u mbështetën në çështjen *Evrin Öktem kundër Turqisë* (nr. 9207/03, § 20, 4 nëntor 2008).

164. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 24 janar 2012, katër kërkuesit (Aishe Selami, Beg Aliu, Dylbere Prini dhe Rabie Gërdeci), çështja e të cilëve ishte shpallur e pranueshme, por e refuzuar në themel, pretenduan se kishin planifikuar të depozitonin një ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të vitit 2012 (brenda afatit ligjor dyvjeçar për të paraqitur ankim kushtetues sipas ligjit shqiptar). Ata argumentuan më tej se hyrja në fuqi e ligjit për amnistinë në nëntor 2012 e kishte bërë të pavlefshme paraqitjen e ankimit kushtetues.

165. Kërkuesit e tjerë në kërkesën nr. 46707/13 parashtuan se rihapja e procedimit penal kundër ish-ministrit të Mbrojtjes, F.M., që kishte qenë mjeti i vetëm në dispozicion të tyre, ishte penguar nga hyrja në fuqi e ligjit për amnistinë. Të gjithë kërkuesit në kërkesën nr. 46707/13 pretenduan se kërkesa e tyre në Gjykatë ishte depozituar brenda afatit gjashtëmujor nga vendimi i fundit i Gjykatës së Rrethit i 3 dhjetorit 2012.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Respektimi i afatit gjashtëmujor

166. Kërkesa nr. 12720/14 u depozitua në Gjykatë më 29 janar 2014. Vendimi i fundit i brendshëm u dha nga Gjykata e Lartë më 19 korrik 2013. Kërkuesit u shprehën se kishin marrë dijeni për vendimin në një artikull në internet më 29 korrik 2013. Duke pasur parasysh faktin që vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ishte në dispozicion të të gjithë publikut dhe që kërkuesit të cilët kishin një interes të provuar në këtë çështje, nuk ishin në gjendje të merrnin tekstin e plotë të vendimit të Gjykatës së Lartë përpara datës 29 korrik 2013, Gjykata konsideron se kërkesa është depozituar brenda afatit kohor gjashtëmujor (shihni, mes vendimeve të tjera, *Ryakib Biryukov kundër*

Rusisë, nr. 14810/02, §§ 30–37, GJEDNJ 2008, në lidhje me parimet e përgjithshme për “shpalljen” e vendimeve të brendshme sipas nenit 6 § 1 të Konventës).

167. Në lidhje me respektimin e afatit gjashtëmujor për kërkesën nr. 63543/09 nuk lind asnjë problem sepse është depozituar më 9 nëntor 2009, brenda gjashtë muajve nga vendimi i Gjykatës së Lartë i 22 majit 2009, i cili veçoi padinë civile nga procesi penal. Në lidhje me kërkesat nr. 46707/13 dhe 46714/13, gjithashtu, nuk lind asnjë problem sepse kërkuessit i kanë paraqitur kërkesat e tyre brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit për amnistinë dhe nga data e vendimit të fundit të gjykatës vendëse.

ii. Shterimi i mjeteve juridike të brendshme

168. Duke pasur parasysh pretendimin e Qeverisë se kërkuessit nuk i kanë shteruar mjetet juridike të brendshme ose sepse kërkesat e tyre civile për dëmshpërblim janë ende në proces ose sepse nuk i kanë paraqitur aspak këto kërkesa, Gjykata në këtë moment do të trajtojë çështjen e përshtatshmërisë së këtyre kërkesave, në lidhje me aspektin procedural të nenit 2 të Konventës.

169. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se edhe në rastet e ndërhyrjeve jo të qëllimshme në të drejtën për jetën ose integritetin fizik, mund të ketë rrethana të jashtëzakonshme kur një hetim penal efektiv është i nevojshëm për të përmbushur detyrimin procedural të parashikuar në nenin 2 (shihni, në kontekstin e aktiviteteve të rrezikshme, *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [GC], nr.41720/13, § 160, 25 qershor 2019; dhe *Vovk dhe Bogdanov*, cituar më lart, § 64; shihni, gjithashtu, në kontekstin e pakujdesisë mjekësore, *Lopes de Sousa a Fernandes kundër Portugalisë* [GC], nr. 56080/13, § 215, 19 dhjetor 2017).

170. Gjykata ka vendosur se në kontekstin e aktiviteteve të rrezikshme ku konstatohet se pakujdesia që u atribuohet zyrtarëve ose organeve të shtetit shkon përtej një gabimi në gjykim ose pakujdesie, për faktin se autoritetet në fjalë duke kuptuar plotësisht pasojat e mundshme dhe duke mos marrë parasysh kompetencat që u janë dhënë, nuk kanë marrë masa të nevojshme dhe të mjaftueshme për të shmangur rreziqet e qenësishme të një veprimtarie të rrezikshme, fakti që personat përgjegjës për shkaktimin e rrezikut ndaj jetës nuk janë akuzuar për vepër penale ose nuk janë ndjekur penalisht, mund të përbëjë shkelje të nenit 2, pavarësisht nga çdo lloj mjeti tjetër juridik që personat mund të ushtrojnë me iniciativën e tyre (shihni *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], nr. 48939/99, § 93, GJEDNJ 2004-XII).

171. Në rastin konkret, një shpërthim masiv ndodhi në një objekt të ngritur nga autoritetet shtetërore dhe nën kontrollin e tyre, ku kryhej një veprimtari e rrezikshme. Raportet e marra gjatë proceseve të brendshme provuan se as zgjedhja e vendit dhe as funksionimi i tij nuk ishin në përputhje me rregullat e sigurisë dhe rregulla të tjera. Shpërthimi ishte i një natyre jashtëzakonisht të gjerë dhe rezultoi me vdekjen e njëzet e gjashtë personave dhe plagosjen e mbi 300 personave. Duke pasur parasysh përmasat e ngjarjeve dhe përfshirjen e zyrtarëve të shtetit në të, Gjykata vlerëson se në rrethanat e kësaj çështjeje kërkohej një përgjigje e së drejtës penale sipas aspektit procedural të nenit 2 të Konventës, pavarësisht se çështja në fjalë ka të bëjë me një aksident dhe jo me vrasje me dashje (krahasoni *Öneryıldız*, cituar më lart, § 113).

172. Nga kjo vijon se kundërshtimi i Qeverisë për shterimin e mjeteve juridike të brendshme, në lidhje me aspektin procedural të nenit 2 të Konventës duhet të rrëzohet.

iii. Konkluzion për pranueshmërinë e aspektit procedural të nenit 2

173. Gjykata vëren se ankimet për aspektin procedural të nenit 2 të Konventës nuk janë as haptazi të pabazuara dhe as të papranueshme për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ato duhet të shpallen të pranueshme.

2. Themeli

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuessit

174. Kërkuesit parashtruan se në kontekstin e procedimit penal që kishin nisur në cilësinë e tyre si palë të dëmtuara, nuk ishte kryer asnjë hetim, aq më shumë efektiv. Kjo ndodhi për shkak se të tre procedimet (dy kundër ish-ministrit të Mbrojtjes dhe një kundër të bashkakuarve të tjerë) ishin pushuar sapo kishin filluar, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit për amnistinë.

175. Kërkuesit pretenduan se përgjegjësia penale e ish-ministrit të Mbrojtjes nuk ishte vlerësuar asnjëherë nga gjykatat vendëse. Përkundrazi, F.M. ishte mbrojtur nga hetimi penal ose për shkak të refuzimit të prokurorit për vazhdimin e hetimit, në lidhje me përgjegjësinë e tij të mundshme penale pas zgjedhjes së tij për një mandat të dytë parlamentar, edhe pse pas ndryshimit kushtetues të tetorit 2012 nuk nevojitej më autorizimi i kuvendit për të filluar procedim penal kundër F.M., ose për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit për amnistinë. Gjithashtu, kërkuesit pretenduan se ligji për amnistinë nuk i kishte shërbyer një qëllimi të ngutshëm social dhe nuk kishte vendosur një ekuilibër të drejtë mes interesit publik dhe së drejtës së kërkuesve për të vërtetën.

176. Për sa i përket fazës së hetimit, ata argumentuan se kërkesa e tyre në prokurori për t'u njohur me dosjen e çështjes ishte refuzuar dhe se atyre u ishte dhënë akses vetëm pas shqyrtimit gjyqësor të kërkesës së tyre.

177. Për sa i përket fazës së gjykimit, kërkuesit u shprehën se, pas vendimit të Gjykatës së Lartë për veçimin e padisë civile, ata ishin përjashtuar plotësisht nga procesi, në lidhje me akuzën kundër njëzet e nëntë të akuzuarve.

178. Në fund, kërkuesit u ankuan se dënimet e dhëna ndaj të pandehurve në proceset e brendshme ishin në mënyrë disproporcionale të buta në krahasim me veprat që ata kishin kryer.

ii. Qeveria

179. Qeveria argumentoi se gjatë dhe menjëherë pas ngjarjes kishte filluar hetimi penal për ngjarjen e Gërdecit me qëllim identifikimin e autorëve dhe kërkuesve iu ishte dhënë statusi i viktimës. Më tej, ata parashtruan se punonjësit e policisë dhe organi i akuzës, pavarësisht kushteve të vështira, kishin marrë masa emergjente procedurale dhe kishin ndërmarrë hapat fillestare procedurale dhe kishin treguar kujdesin e nevojshëm për identifikimin dhe nxjerrjen e autorëve përpara drejtësisë.

180. Qeveria më tej argumentoi se procedimi ndaj ish-ministrit të Mbrojtjes, F.M ishin ndërprerë për shkak të rizgjedhjes deputet më 1 gusht 2009.

181. Ndjekja penale ndaj tij ishte ndërprerë në zbatim të nenit 73 § 2 të Kushtetutës, i cili parashikonte se deputetët nuk mund të ndiqeshin penalisht pa një autorizim nga kuvendi.

182. Në përgjithësi, Qeveria insistoi që, përveç zbatimit të kuadrit ligjor përkatës, kishte ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të ndjekur penalisht autorët e ngjarjes.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parime të përgjithshme

183. Në rastin e humbjes së jetës në rrethana që mund të përfshijnë përgjegjësinë e shtetit, neni 2 i Konventës parashikon detyrimin e shtetit që të sigurojë, me të gjitha mjetet që disponon, një përgjigje të përshtatshme – gjyqësore ose ndryshe – në mënyrë që kuadri ligjor dhe administrativ i krijuar për të mbrojtur të drejtën për jetën siç duhet dhe çdo shkelje e kësaj të drejte të goditet dhe të dënohet (shihni *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 15339/02 dhe 4 të tjerë, § 138, GJEDNJ 2008 (ekstrakte)). Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se nëse shkelja e së drejtës për jetën ose integritetit fizik nuk është shkaktuar me dashje, detyrimi pozitiv për të ngritur një “sistemi gjyqësor efektiv” nuk kërkon domosdoshmërisht fillimin e një procedimi penal në çdo rast dhe mund të mjaftohet me vënien në dispozicion të viktimave të mjeteve juridike civile, administrative apo edhe disiplinore (ibid, § 139, me referenca të mëtejshme).

184. Megjithatë, mund të ketë rrethana të jashtëzakonshme kur nevojitet një hetim penal efektiv për të përmbushur detyrimin procedural të parashikuar në nenin 2. Rrethana të tilla mund të jenë të

pranishme, për shembull, në rastin e humbjes së jetës ose vënies të jetës në rrezik për shkak të sjelljes së një autoriteti publik që shkon përtej një gabimi në gjykim ose pakujdesie. Kur provohet se pakujdesia që u atribuohet zyrtarëve ose organeve të shtetit shkon përtej një gabimi në gjykim ose pakujdesie, për faktin se autoritetet në fjalë, duke kuptuar plotësisht pasojat e mundshme dhe duke mos marrë parasysh kompetencat që u janë dhënë, nuk kanë marrë masa të nevojshme dhe të mjaftueshme për të shmangur rreziqet e qenësishme të një veprimtarie të rrezikshme, fakti që personat përgjegjës për shkaktimin e rrezikut ndaj jetës nuk janë akuzuar për vepër penale ose nuk janë ndjekur penalisht, mund të përbëjë shkelje të nenit 2, pavarësisht nga çdo lloj mjeti tjetër juridik që personat mund të ushtrojnë me iniciativën e tyre. Në kontekstin e veçantë të aktiviteteve të rrezikshme, Gjykata ka konsideruar se një hetim penal zyrtar është i domosdoshëm duke qenë se autoritetet publike shpesh janë të vetmet subjekte që kanë njohuri të mjaftueshme përkatëse për të identifikuar dhe për të vërtetuar fenomenet komplekse që mund të kenë shkaktuar një ngjarje (shihni *Öneryıldız*, cituar më lart, §§ 71 dhe 93, *Oruk kundër Turqisë*, nr. 33647/04, §§ 56–66, 4 shkurt 2014; *Vovk dhe Bogdanov*, cituar më lart, § 64; dhe *Budayeva dhe të tjerët*, cituar më lart, § 140).

185. Parimet përkatëse të zbatueshme për hetimin efektiv janë përmbledhur nga Gjykata në shumë çështje si më poshtë (shihni, për shembull, *Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 5878/08, §§ 229–39, 30 mars 2016): ata që janë përgjegjës për kryerjen e një hetimi duhet të jenë të pavarur nga personat e implikuar në ngjarjet në fjalë; hetimi duhet të jetë “adekuat”; konkluzionet e tij duhet të bazohen në një analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve përkatës; ai duhet të kryhet menjëherë dhe me shpejtësi të arsyeshme (po aty, § 240); dhe viktimat ose të afërmit e tyre kur viktimat nuk ka mbijetuar duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive në hetim në një formë ose në një tjetër në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime (shihni *El Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], nr. 39630/09, § 185, GJEDNJ 2012, dhe *Neškoska kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 60333/13, § 49, 21 janar 2016). Këta elementë janë të ndërlidhur dhe secili prej tyre, i marrë veçmas, nuk përbën një qëllim në vetvete. Përkundrazi, ato janë kritere të cilat, të marra së bashku, mundësojnë vlerësimin e shkallës së efektivitetit të hetimit (shihni *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* [GC], nr. 24014/05, § 225, 14 prill 2015).

186. Që hetimi të jetë “efektiv”, siç duhet kuptuar kjo shprehje në kontekstin e nenit 2 të Konventës, së pari duhet të jetë adekuat. Kjo do të thotë se duhet të jetë në gjendje të çojë në vërtetimin e fakteve dhe të identifikojë dhe – nëse është e përshtatshme – të ndëshkojë përgjegjësit. Ky nuk është një detyrim për rezultate, por për mjete (shihni *Ramsabai dhe të tjerët kundër Holandës* [GC], nr. 52391/99, § 324, GJEDNJ 2007 II; *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* [GC], cituar më sipër, § 173; dhe *Armani Da Silva*, cituar më lart, § 233).

187. Në rastet e aktiviteteve të rrezikshme, autoritetet kompetente duhet të veprojnë me kujdes dhe shpejtësi shembullore dhe duhet të fillojnë kryesisht hetime së pari që të përcaktojnë rrethanat në të cilat ndodhi ngjarja dhe çdo mangësi në funksionimin e sistemit rregullator dhe, së dyti, të identifikojnë zyrtarët ose autoritetet shtetërore të përfshirë në çfarëdo cilësie në zinxhirin e ngjarjeve në fjalë (shihni *Öneryıldız*, cituar më lart, § 94, dhe *Budayeva dhe të tjerët*, cituar më lart, § 142).

188. Gjithashtu, kërkesat e nenit 2 shkojnë përtej fazës së hetimit zyrtar, kur kjo ka çuar në fillimin e gjykimit në gjykatat kombëtare: procesi në tërësi, duke përfshirë fazën e gjykimit, duhet të plotësojnë kërkesat e detyrimit pozitiv për mbrojtjen e jetës përmes ligjit (shihni *Öneryıldız*, cituar më lart, § 95). Edhe pse nuk ekziston asnjë detyrim absolut që të gjitha procedimet penale të finalizohen me dënime ose me një dënim të caktuar, gjykatat e brendshme në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë të përgatitura për të lejuar që veprat penale që kërcënojnë jetën të mbeten të pandëshkuara.

189. Për sa i përket dënimit, Gjykata është shprehur se edhe pse gjykatat kombëtare duhet të respektohen në thelb për zgjedhjen e dënimeve të përshtatshme për keqtrajtimit dhe vrasje, Gjykata

duhet të ndërhyjë në çështjet e disproporcionit të hapur ndërmjet rëndesës së aktit dhe dënimit të urdhëruar (shihni *Bektaş dhe Özalp kundër Turqisë*, nr. 10036/03, § 50, 20 prill 2010, dhe *Nikolova dhe Velichkova kundër Bullgarisë*, nr. 7888/03, § 61, 20 dhjetor 2007). Prandaj, detyra e Gjykatës konsiston në shqyrtimin nëse dhe në çfarë mase gjykatat, për arritjen e përfundimit të tyre, mund të konsiderohet se e kanë shqyrtuar çështjen me kujdesin e kërkuar nga neni 2 i Konventës, në mënyrë që efekti parandalues i sistemit gjyqësor në vendi dhe rëndësia e rolit që kërkohet të luajë për parandalimin e shkeljeve të së drejtës për të jetuar të mos cenohen (shihni *Vazagashvili dhe Shanava kundër Gjeorgjisë*, nr. 50375/07, § 84, 18 korrik 2019, me referenca të mëtejshme).

190. Në fund, Gjykata është shprehur tashmë se kur një punonjës i shtetit dënohet për një krim që shkel nenin 2 ose 3 të Konventës, dhënia më pas e amnistisë ose falja vështirë se mund të thuhet se i shërben qëllimit të një dënimi adekuat. Përkundrazi, shtetet duhet të jenë edhe më të rrepta kur ndëshkojnë punonjësit e tyre për kryerjen e krimeve të rënda që rrezikojnë jetën krahasuar me autorët e zakonshëm, sepse ajo që vihet në lojë nuk është vetëm çështja e përgjegjësisë individuale penale e autorëve, por edhe detyra e shtetit për të luftuar ndjenjën e pandëshkueshmërisë që autorët mund të mendojnë se e gëzojnë për shkak të detyrës së tyre (shihni *Makuchyan dhe Minasyan kundër Azerbajxhanit dhe Hungarisë*, nr. 17247/13, § 157, 26 maj 2020).

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

α) Hetimi

- Nëse hetimi ishte adekuat

191. Për sa i përket hetimit të kësaj çështjeje, Gjykata vëren fillimisht se, sapo mësuan për ngjarjen në Gërdec, autoritetet kompetente vendëse, përkatësisht Prokuroria e Përgjithshme (këtu e më poshtë “Prokurori”), filloi kryesisht hetimin për rrethanat e ngjarjes, në të njëjtën ditë që ndodhi ngjarja.

192. Autoritetet shqiptare kërkuar, gjithashtu, ndihmë nga ATF-IRT, njësi federale amerikane e hetimit të ngjarjeve me eksploziv, me autoritet hetimor kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar kështu ekspertizën e nevojshme.

193. Si Prokurori ashtu edhe ATF-IRT kryen kontrollat në vendngjarje sa më shpejt ishte e mundur, morën në pyetje dëshmitarët, përfshirë kërkuesit, dhe ekzaminuan videoregjistrimet dhe fotografitë e objektit para ngjarjes.

194. Prokurori kërkoi edhe një akt ekspertimi nga ekspertët ushtarakë dhe gjithsej u prodhuan tri raporte, një nga Prokurori, një nga ATF IRT dhe i treti nga ekspertë ushtarakë.

195. Këto raporte përcaktuan shkakun më të mundshëm të aksidentit dhe vunë në dukje një sërë dështimesh, në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e objektit të Gërdecit dhe mungesën e masave adekuate të sigurisë (shihni paragrafët 21–55 më lart). Pikat kryesore të të tri akteve mund të përmbledhen si më poshtë.

196. Zgjedhja e Gërdecit si vendi i objektit të çmilitarizimit të armëve ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e shtetit. Zona nuk ishte licencuar për ruajtjen dhe çmontimin e municioneve. Zona e Gërdecit, e cila administrohej nga Ministria e Mbrojtjes, nuk ishte licencuar për t’u përdorur si depo municioni. Një operacion i kësaj përmase nuk duhej të ishte kryer kurrë në një vendndodhje pranë rrugëve publike dhe banesave.

197. Procedurat e përdorura në objektin e Gërdecit kishin qenë të pasigurta dhe jo në përputhje me standardet normale të punës në vendet e punës që kishin të bënin me eksplozivë dhe lëndë djegëse. Procesi i çmilitarizimit kishte mbartur një shkallë rreziku në vetvete, pasi kishte konsistuar në ruajtjen e municioneve, çmontimin e tyre dhe ndarjen dhe ruajtjen e nënprodukteve. Prandaj, përcaktimi i objektit ushtarak të Gërdecit për qëllime çmilitarizimi duhet të shoqërohej me licencimin e magazinës dhe objekteve ku supozohej se do të zhvilloheshin operacionet e çmilitarizimit. Megjithatë, municionet nuk ishin shkarkuar dhe ruajtur në magazina të veçanta, larg

zonës së përdorur për operacionet e çmilitarizimit. Nuk kishte magazina të licencuara për ruajtjen e municioneve të dorëzuara nga forcat e armatosura. Sapo të lidhej kontrata e dytë me kontraktorin tregtar, duhej të ishin marrë një sërë masash përpara autorizimit të furnizimit me materiale dhe fillimit të punës. Disa nga masat duhej të përfshinin një inspektim paraprak të makinerive të çmontimit, respektimin e masave të sigurisë nga zjarri, vlerësimin e kualifikimeve dhe trajnimin e personelit, në lidhje me masat e sigurisë teknike dhe kapacitetin e magazinimit të kontraktorit. Autoriteti shtetëror përgjegjës nuk e kishte kryer këtë inspektim.

198. Çmontimi i municionit nuk korrespondonte me çmilitarizimin e tij siç ishte parashikuar në kontratë. Infrastruktura e objektit nuk kishte përmbushur standardet e sigurisë për kryerjen e operacioneve të çmilitarizimit, të cilat ishin kryer në dy vende të hapura të pambrojtura nga ekspozimi ndaj rrezeve të diellit. Nuk kishte kontejnerë rezistent ndaj shpërthimit me të cilët mund të kryheshin operacione të rrezikshme. Teknologjia e përdorur për çmontimin nuk ishte e sigurt. Nuk ishte përdorur asnjë makineri dhe pajisjet nuk ishin në përputhje me kërkesat e sigurisë. Për sa i përket transportit në vend, mjetet e përdorura nuk kishin përmbushur masat e sigurisë të nevojshme për të punuar me materiale të rrezikshme. Objekti nuk ishte i pajisur me fikse zjarri apo sistem automatik spërkatës, as nuk ishte instaluar ndonjë sistem mbrojtjeje nga rrufeja. Mbeturinat, materialet shpërthyes dhe predhat e shkrira të pasiguruara dhe qeset e lëndëve djegëse ishin lënë në dysheme.

199. Transporti nga depoja e armëve për në objektin e çmilitarizimit të armëve Gërdec ishte kryer me automjete të Forcave të Armatosura. Nuk kishte një grafik transporti, në kundërshtim me një urdhër të lëshuar nga ministri i Mbrojtjes.

200. Në lidhje me punëtorët, pas zbatimit të kontratës së dytë më 28 dhjetor 2007, ata nuk kishin lexuar apo edhe parë ndonjë rregullore, në lidhje me masat e sigurisë teknike, as nuk ishin trajnuar përpara se të fillonin punën. Çmontimi i municioneve ishte kryer nga punëtorë të patrajnuar duke përdorur automjete të cilat nuk ishin në përputhje me standardet e sigurisë. Intervistat me punëtorët zbuluan se ata nuk kishin pasur një zonë të caktuar për pirjen e duhanit dhe nuk ishin vendosur tabela “ndalohet duhani”. Për më tepër, atyre nuk u ndalohej të mbanin shkrepe, çakmakë apo duhan në vendin e punës. Asnjë uniformë pune nuk ishte caktuar për punëtorët. Përveç kësaj, atyre nuk u ishte kërkuar të mbanin veshje antistatike dhe as nuk kishin marrë ndonjë udhëzim për të parandaluar rreziqet nga elektriciteti statik.

201. Forcat e armatosura supozohej të mbanin përgjegjësinë për sigurimin dhe mbrojtjen e objektit, ndërsa MEICO pritej të mbikëqyrte në përgjithësi aktivitetin e çmilitarizimit.

202. Po ashtu ishte kërkuar një akt ekspertimi mjekoligjor për plagët e marra nga viktimat e ngjarjes.

203. Hetimi në tërësi rezultoi në ngritjen e akuzave kundër njëzet e nëntë personave, përfshirë edhe një ish-ministër të mbrojtjes, drejtuesin e MEICO-s, menaxherin dhe menaxherin e objektit nga Albademil sh.p.k., Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe një numër punonjësish dhe personeli ushtarak i Ministrisë së Mbrojtjes, si edhe vetë Albademil sh.p.k. (shihni paragrafin 62 më lart). Të gjitha raportet e lartpërmendura të prodhuara gjatë hetimit kanë shërbyer si bazë për akuzën dhe janë përdorur si provë në gjykimin kundër të akuzuarve.

204. Kështu, Gjykata del në përfundimin se hetimi ishte adekuat në faktin që në përgjithësi ia doli të përcaktonte rrethanat e ngjarjes dhe identifikoi përgjegjësit e saj (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, §§ 183–209, dhe *Hanan kundër Gjermanisë* [GC], nr. 4871/16, § § 211–219, 16 shkurt 2021).

- *Pjesëmarrja e kërkuarve në fazën e hetimit*

205. Gjykata vë në dukje pretendimin e kërkuarve që ata i kërkuan Prokurorisë të njiheshin me dosjen e çështjes në fazën e hetimit dhe që kërkesa e tyre u refuzua dhe iu dha një kopje e saj vetëm

në përfundim të hetimit. Megjithatë, kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tyre. Nga ana tjetër, Qeveria nuk i ka kundërshtuar këto pretendime.

206. Edhe duke supozuar se deklarimi i kërkuesve në këtë drejtim është i saktë, Gjykata thekson si më poshtë.

207. Për sa i përket aksesit në hetim dhe ekzistencës së kontrollit të mjaftueshëm publik, Gjykata tashmë ka theksuar rëndësinë e së drejtës së viktimave, familjeve dhe trashëgimtarëve të tyre për të mësuar të vërtetën rreth rrethanave që lidhen me ngjarjet që përfshijnë një shkelje masive të të drejtave, aq themelore sa e drejta për jetën. Megjithatë, Gjykata vëren që ky aspekt i detyrimit procedural nuk kërkon që kërkuesit të njihen me dosjet e policisë, ose kopjet e të gjitha dokumenteve gjatë një hetimi në vazhdim, ose që ata të konsultohen ose të informohen për çdo hap (shihni *Brecknell kundër Mbretëria e Bashkuar*, nr. 32457/04, § 77, 27 nëntor 2007; *Mezhiyeva kundër Rusisë*, nr. 44297/06, § 75, 16 prill 2015; dhe *Hovhannisyan dhe Nazaryan kundër Armenisë*, nr. 2129/87 dhe 14, § 173, 8 nëntor 2022; shihni, gjithashtu, *Gürtekin dhe të tjerët kundër Qipros* (vendim), nr. 60441/13 dhe 2 të tjerë, § 29, 11 mars 2014; *Mujkanoviæ dhe të tjerë kundër Bosnjë Hercegovinës* (vendim), nr. 47063/08 dhe 5 të tjerë, § 40, 3 qershor 2014; dhe *Fazliq dhe të tjerë kundër Bosnjë Hercegovinës* (vendim), nr. 66758/09 dhe 4 të tjerë, § 38, 3 qershor 2014).

208. Edhe pse kërkuesve nuk iu dha akses në dosjen hetimore të çështjes gjatë kohës që hetimi ishte në proces, ata u njohën me të gjithë dosjen në fund të hetimit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ngjarja në fjalë ndodhi më 15 mars 2008 dhe hetimi përfundoi brenda një viti. Nga kjo rrjedh se hetimi ishte i shpejtë dhe se kërkuesit nuk u desh të prisnin shumë vite për të mësuar rreth rezultateve të hetimit (krahasoni *Shoqata "21 dhjetor 1989"* dhe të tjerë kundër Rumanisë, nr. 33810/07 dhe 18817/08, §§ 140–41, 24 maj 2011).

209. Për më tepër, siç u tha më lart, Gjykata konstaton se autoritetet vërtetuan të gjitha faktet relevante gjatë hetimit, dhe kërkuesit nuk kanë vënë në dukje ndonjë gabim ose mosveprim të veçantë nga ana e autoriteteve hetimore, ose një fakt të veçantë që nuk është vërtetuar, ose një linjë të veçantë hetimi që nuk është ndjekur.

210. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesve u është dhënë akses në hetim në masën e duhur të nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime (krahasoni *Gribben kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 28864/18, § 136, 25 janar 2022).

β) Gjykimi penal kundër njëzet e nëntë të akuzuarve
- *Akuzat e ngritura kundër të akuzuarve dhe dënimit e dhëna*

211. Gjykata vëren se pas hetimit, u ngritën akuza ndaj njëzet e nëntë të akuzuarve, në lidhje me ngjarjen e Gërdecit dhe se ata u gjykuan në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Prandaj, çështja për vlerësim është nëse autoritetet gjyqësore, si rojtarë të ligjeve të përcaktuara për të mbrojtur jetën dhe integritetin fizik dhe moral të personave brenda juridiksionit të tyre, ishin të vendosura që të dënonin përgjegjësit. Ndonëse është e vërtetë se Gjykata nuk e ka për detyrë të trajtojë çështje të së drejtës së brendshme në lidhje me përgjegjësinë penale individuale, ose të japë vendime fajësie ose pafajësie, me qëllim që të përcaktojë nëse Qeveria e paditur ka përmbushur përgjegjësinë e saj të së drejtës ndërkombëtare sipas Konventës, Gjykata duhet të ketë parasysh konsideratat e gjykatave kombëtare kur dënojnë të akuzuarit kryesor dhe masën e dënimit të caktuar ndaj tyre. Ndërkohë që e bën këtë, Gjykata duhet të respektojë në masë të konsiderueshme gjykatat kombëtare për zgjedhjen e dënimeve të përshtatshme. Megjithatë, ajo përsëri duhet të ushtrojë kompetencën e caktuar të rishikimit dhe të ndërhyjë në rastet e disproporcionit të dukshëm ndërmjet rëndesës së veprës dhe masës së dënimit të dhënë (shihni *Ali dhe Aysë Duran kundër Turqisë*, nr. 42942/02, § 66, 8 prill 2008, me referenca të mëtejshme).

212. Ndërkohë që nuk është detyrim absolut që të gjitha procedimet penale të rezultojnë në dënim ose në një dënim të caktuar, gjykatat kombëtare në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë të

përgatitura për të lejuar që aktet e pakujdesisë së rëndë që kanë rezultuar në humbjen e jetës ose që kanë rrezikuar rëndë jetën të mos ndëshkohen, ose që veprat e rënda penale të dënohen me dënime tepër të buta. Prandaj, pika e rëndësishme që duhet të shqyrtojë Gjykata është nëse dhe në çfarë mase gjykatat, për arritjen e përfundimit të tyre, mund të konsiderohet se e kanë shqyrtuar çështjen me kujdesin e kërkuar nga neni 2 i Konventës, në mënyrë që efekti parandalues i sistemit gjyqësor në vend dhe rëndësia e rolit që kërkohet të luajë për parandalimin e shkeljeve të së drejtës për të jetuar të mos cenohen (po aty, §§ 61–62; shih, gjithashtu, *Armani Da Silva*, cituar më lart, § 285; *Sabalić kundër Kroacisë*, nr. 50231/13, § 97, 14 janar 2021; dhe, në përgjithësi, *Öneryıldız*, cituar më lart, §§ 116–18).

213. Sa u përket akuzave të ngritura ndaj të akuzuarve, ato kishin të bënin me veprën penale të vrasjes, shpërdorimit të detyrës, falsifikimit të dokumenteve dhe shkeljes së rregullave të sigurisë.

214. Njëzet e katër të akuzuar u shpallën fajtorë. Në fund, asnjë nga të akuzuarit kryesorë nuk u shpall fajtor për vrasje, por për vepra të tjera penale si shkelje e rregullave të sigurisë, prodhim dhe mbajtje armësh dhe municioni në punë, shpërdorim detyre dhe shkatërrim i pronës nga pakujdesia.

215. Duke pasur parasysh që në çështjet e vrasjeve me dashje, veçanërisht nga zyrtarët e shtetit, detyrimi procedural sipas nenit 2 të Konventës në parim do të kërkonte ngritjen e një akuzë adekuate që duhet t'i referohet vrasjes, nuk ndodh domosdoshmërisht kështu kur bëhet fjalë për akuza specifike në lidhje me vdekjet si pasojë e aksidenteve. Në rrethana të tilla, autoritetet kombëtare janë në pozitë më të mirë për të vlerësuar rolin, detyrat dhe pozicionin e çdo individi në lidhje me ngjarjen dhe përgjegjësinë e tij/saj në këtë drejtim.

216. Në këtë çështje, edhe pse asnjë nga të akuzuarit kryesorë nuk është dënuar në fund për vrasje, të gjitha veprat për të cilat ata janë dënuar kishin të bënin me ngjarjen e Gërdecit dhe dënimet e tyre i referoheshin në mënyrë specifike shkaktimit të vdekjes dhe plagosjes së disa personave. Prandaj, dënimet e të akuzuarve kryesorë lidhen me aktet që rrezikojnë jetën dhe mbrojtjen e së drejtës për jetë sipas kuptimit të nenit 2 (krahasoni *Öneryıldız*, cituar më lart, § 116).

217. Për sa i përket dënimit, Gjykata më parë ka gjetur shkelje të aspektit procedural të nenit 2 të Konventës në çështjet kur zyrtarët e shtetit kanë shkaktuar vdekjen nga veprime të brutalitetit policor dhe ku ekzekutimi i dënimeve të dhëna ndaj tyre është pezulluar (shihni *Ali dhe Ayşe Duran*, cituar më sipër, §§ 70–72; *Bektaş dhe Özalp*, cituar më lart, § 50; *Fadime dhe Turan Karabulut kundër Turqisë*, nr. 23872/04, § 47, 27 maj 2010; dhe *Külah dhe Koyuncu kundër Turqisë*, nr. 24827/05, § 60, 23 prill 2013); ose dënimi është ekzekutuar me vonesë të konsiderueshme (shihni *Kitanovska Stanojkovic dhe të tjerët kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 2319/14, §§ 31–33, 13 tetor 2016); ose ata nuk janë dënuar për shkak të parashkrimit të dënimit (shihni *Przemyk kundër Polonisë*, nr. 22426/11, § 71, 17 shtator 2013, dhe *Nina Kutsenko kundër Ukrainës*, nr. 25114/11, § 150, 18 korrik 2017); ose dënimi ka qenë shumë i butë (shih *Przemyk*, cituar më sipër, § 72, ku një oficer policie fillimisht u dënua me katër vjet burgim i akuzuar për rrahje që rezultoi në vdekje, dhe më pas dënimi u ul në dy vjet burgim, dhe *Yeter kundër Turqisë*, nr. 33750/03, § 68, 13 janar 2009, ku një oficer policie fillimisht u dënua me dhjetë vjet burgim i akuzuar për torturë që rezultoi në vdekje, dhe më pas dënimi u ul në katër vjet e dy muaj burgim dhe ai vuajti vetëm nëntëmbëdhjetë ditë); ose ku oficerëve të policisë që kryen vrasjen nuk ju ndaluar mbajtja e detyrave në shërbimin publik (shihni *Vazagashvili dhe Shanava*, cituar më lart, § 92, ku dy oficerë policie të dënuar për vrasje në rrethana rënduese të djalit të kërkuesit u dënuan me dymbëdhjetë vjet burgim, por që mund t'i bashkoheshin sistemit të zbatimit të ligjit të shtetit të paditur sërish pasi të kishin vuajtur dënimin me burg); ose ku gjykata e faktit pezulloi shpalljen e vendimit për veprën e vrasjes së paligjshme me arsyetimin se nuk ishte kryer me dashje (shihni, për shembull, *Kasap dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 8656/10, § 60, 14 janar 2014, dhe *Hasan Köse kundër Turqisë*, nr. 15014/11, § 37, 18 dhjetor 2018).

218. Gjykata fillimisht vëren se çështja në fjalë nuk ka të bëjë me vrasje me dashje, por pakujdesi, ndonëse e rëndë. Megjithatë, edhe akuzat për pakujdesi të rëndë që rezultojnë në vdekje nuk mund të krahasohen me ato të ngritura kundër zyrtarëve të shtetit për vrasje me dashje.

219. Sa u përket dënimeve të dhëna ndaj të akuzuarve kryesorë Gjykata vëren se Y.P. dhe D.M. fillimisht janë dënuar me tetëmbëdhjetë vite burg, M.D dhe S.N me dhjetë vite burg dhe L.H me gjashtë vite burg.

220. Megjithatë, Gjykata e Apelit Tiranë zbatoi gjykimin e shkurtuar për Y.P., D.M. dhe M.D., që rezultoi në ulje automatike të dënimit të tyre me një të tretën. Kështu, Y.P u dënua me dhjetë vite burg, D.M me dymbëdhjetë dhe M.D me gjashtë vite e nëntë muaj burgim, ndërsa dënimet ndaj S.N dhe L.H u lanë në fuqi.

221. Më pas, Y.P u lirua me kusht, pasi kishte vuajtur ditë dënimin me burg për pesë vite, nëntë muaj e tetëmbëdhjetë . M.D iu ul dënimi me shtatëdhjetë ditë për shkak të sjelljes së tij shembullore në burg. Ai vuajti dënimin me burg për pesë vite e gjashtë ditë. S.N iu ul dënimi me nëntëdhjetë ditë. D.M vuajti dënim me burg për gjashtë vite, njëmbëdhjetë muaj dhe njëzet e shtatë ditë.

222. Pyetja është nëse gjykatat kanë shqyrtuar me kujdes caktimin e dënimeve ndaj personave të shpallur përgjegjës, duke pasur parasysh përmasat e ngjarjes së Gërdecit dhe numrin e viktimave. Ndonëse është e vërtetë që disa nga dënimet u ulën më pas, uljet në dënimet fillestare nuk i bënë ato të buta në mënyrë disproporcionale. Në lidhje me faktin që të akuzuarit më pas vuajtën edhe më pak kohë në burg, Gjykata vëren se pasi një i dënuar fillon të vuajë dënimin, lirimi me kusht ose ulja e dënimit është një veçori normale e sistemeve të drejtësisë penale dhe mund të jetë rezultat i rrethanave të ndryshme, siç është sjellja e të dënuarit në burg. Koha e vuajtur në burg nga të akuzuarit kryesorë nuk mund të konsiderohet si haptazi në disproporcion me rëndesën e veprave të kryera prej tyre.

- Pjesëmarrja e kërkuësve në gjykimin penal

223. Kërkuësit në kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14 kanë paraqitur padi civile kundër disa prej të akuzuarve. Më 22 maj 2009, Gjykata e Lartë veçoi padinë e tyre civile nga procesi penal. Zamira Durdaj u ankua në Gjykatën Kushtetuese se veçimi i padisë civile nga gjykimi penal e kishte penguar të merrte pjesë në gjykimin penal, sepse i kishte hequr atyre, gjithashtu, çdo mundësi për të marrë pjesë në gjykimin penal, për shembull, për të marrë në pyetje dëshmitarët, për të paraqitur dokumentacion shtesë, për të kërkuar ekspertizë dhe për të thirrur dëshmitarë, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e kontradiktoritetit në procesin gjyqësor. Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin e saj, duke konstatuar se Gjykata e Lartë kishte vepruar në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe duke mos adresuar ankimin e saj specifik për refuzimin e pjesëmarrjes aktive në procesin penal kundër përgjegjësve për ngjarjen e Gërdecit ku humbi jetën djali i saj.

224. Gjykata vëren se, pasi Gjykata e Lartë e veçoi padinë civile të kërkuësve nga gjykimi penal, ata nuk u informuan më për asnjë nga hapat e ndërmarrë në gjykimin penal. Gjykata vëren se kjo ka ndodhur më 22 shtator 2009, para se të kishte filluar gjykimi në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Me fillimin e gjykimit kundër njëzet e nëntë të akuzuarve në Gjykatën e Rrethit Tiranë, kërkuësit nuk u informuan për seancat dhe nuk u ftuan të merrnin pjesë në gjykim në asnjë cilësi.

225. Sipas legjislacionit shqiptar të asaj kohe, pala e dëmtuar që nuk kishte depozituar padi civile gjatë gjykimit penal nuk kishte të drejtë të merrte pjesë aktive në gjykimin kundër të akuzuarit për të paraqitur prova, për të marrë në pyetje dëshmitarët ose të pandehurit apo për të komentuar mbi provat e mbledhura. Kështu, edhe pse seancat e mbajtura para gjykatave vendëse, në parim, ishin të hapura për publikun dhe oraret e seancave mund të ishin të disponueshme (shihni *Seremet kundër Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë* (vendim), nr. 29620/05, § 36, 8 korrik 2014), kërkuësit do të kishin mundësi të ndiqnin gjykimin vetëm si anëtarë të publikut të gjerë, pa ndonjë të drejtë

specifike. Ata nuk do të kishin pasur një mundësi reale për të marrë pjesë në mënyrë aktive në gjykim siç është përshkruar nga Zamira Durdaj në ankimin e saj në Gjykatën Kushtetuese.

226. Përveç kësaj, vendimet e marra gjatë gjykimit penal nuk iu njoftuan kërkuesve dhe ata nuk kishin të drejtë ankimi kundër tyre. Prandaj, në rrjedhën e gjykimit penal, kërkuesit nuk kishin të drejta procedurale.

227. Për sa i përket pretendimit të Qeverisë se kërkuesit mund të kishin ushtruar të drejtat e tyre gjatë procesit në lidhje me një padi civile për dëmshpërblim, Gjykata vëren se ajo tashmë ka përcaktuar se detyrimi procedural i shtetit sipas nenit 2 të Konventës në rrethanat e çështjes në fjalë kërkonte një përgjigje të ligjit penal, dhe për këtë arsye kërkuesve duhej t'u jepej mundësia të merrnin pjesë në mënyrë efektive në procesin penal, duke përfshirë edhe fazën e gjykimit, në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime (shihni *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, § 73, GJEDNJ 2002-II; shihni, gjithashtu, paragrafin 155 më lart). Kjo nuk mund të kompensohet nga mundësia e kërkuesve për të paraqitur një padi civile në një proces të veçantë civil, pasi ky proces do të shqyrtonte vetëm padinë civile të kërkuesve dhe jo përgjegjësinë penale të akuzuarve. Kërkesa për të lejuar përfshirjen e viktimave vështirë se mund të plotësohet kur viktimat e shkeljeve sipas nenit 2 të Konventës ose të afërmit e tyre nuk kanë mundësi të marrin pjesë në procesin penal kundër autorëve të këtyre shkeljeve (krahasoni *Oğur kundër Turqisë* [GC], nr. 21594/93, § 92, GJEDNJ 1999-III; *Boboc dhe të tjerë kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 44592/16, § 53, 7 qershor 2022; *Shavadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 72080/12, § 35, 19 nëntor 2020; *Vazagashvili dhe Shanava*, cituar më lart, § 91; *Iorga kundër Moldavisë*, nr. 12219/05, §§ 35 dhe 36, 23 mars 2010; dhe *Pisari kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 42139/12, § 59, 21 prill 2015).

γ) Procesi ndaj ish-ministrit të Mbrojtjes

228. Neni 2 nuk parashikon të drejtën e një kërkuesi që të ketë palë të tjera të ndjekura penalisht ose të dënuara për një veprë penale (shihni, mes shumë vendimeve, *Budayeva dhe të tjerë*, cituar më lart, § 144). Me fjalë të tjera, shteti i paditur nuk është i detyruar të ndjekë penalisht personat të cilët kërkuesi dëshiron që të mbajnë përgjegjësi (shihni *Van Melle dhe të tjerët kundër Holandës* (vendim), nr. 19221/08, 29 shtator 2009). Nga ana tjetër, gjykatat kombëtare në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë të përgatitura për të lejuar që veprat që rrezikojnë jetën të mbeten pa u ndëshkuar (shihni *Mazepa dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 15086/07, § 69, 17 korrik 2018, dhe *Randelović dhe të tjerët kundër Malit të Zi*, nr. 66641/10, § 123, 19 shtator 2017; shihni, gjithashtu, *Öneriyıldız*, cituar më lart, §§ 95–96).

229. Në këtë çështje, Prokurori pati si synim fillimin e hetimit penal, *inter alia*, ndaj F.M, Ministër i Mbrojtjes, për të cilin prokuroria duhej të merrte pëlqimin e Kuvendit sipas ligjit në fuqi në atë kohë. Kuvendi fillimisht hoqi imunitetin parlamentar për të lejuar hetimin dhe ndjekjen penale të F.M. Për rrjedhojë, ndaj tij filloi hetimi penal. Gjatë hetimit, u mblodhën prova të cilat sipas prokurorisë përbënin bazë të mjaftueshme për ngritjen e akuzës kundër F.M. Akuza u ngrit përpara Gjykatës së Lartë për veprat penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare, prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit dhe municionit, dhe për veprën penale ushtarake të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim me një ushtarak (shihni paragrafin 62 më lart). Megjithatë, F.M më pas u rizgjodh deputet (shihni paragrafin 101 më lart). Kjo rizgjedhje i dha atij imunitet të ripërtërirë parlamentar, gjë që pengoi vijimin e ndjekjes penale kundër tij dhe Gjykata e Lartë e pushoi procedimin kundër F.M. më 14 shtator 2009 (shihni paragrafin 102 më lart). Pas kësaj, prokuroria nuk kërkoi autorizim të ri nga Kuvendi, gjë që rezultoi në ndërprerjen e çdo përpjekjeje të mëtejshme për të provuar përgjegjësinë e F.M për ngjarjen e Gërdecit (krahasoni *Carter kundër Rusisë*, nr. 20914/07, § 145, 21 shtator 2021). As prokuroria dhe as qeveria nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim se pse nuk është kërkuar autorizimi i ri nga Kuvendi.

230. Që nga 26 tetori 2012, imuniteti parlamentar nuk ka qenë pengesë për institucionin apo vazhdimin e hetimit penal të një deputeti. Megjithatë, Prokurori nuk e rihapi e procedimin penal

kundër F.M. deri më 5 maj 2021 (shihni paragrafin 115 më lart). Sërish, as prokuroria dhe as qeveria nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim se pse hetimi nuk rifilloi menjëherë pas heqjes së pengesës së lartpërmendur, por vetëm nëntë vite më vonë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në një intervistë televizive të 25 prillit 2013, Prokurori i Përgjithshëm u shpreh se hetimi ndaj F.M. nuk do të rifillonte në mungesë të provave të reja (shihni paragrafin 114 më lart). Megjithatë, ky qëndrim binte ndesh me faktin se prokuroria tashmë kishte ngritur akuzë kundër F.M., gjë që tregonte se kishte vlerësuar se provat mbi të cilat ishte bazuar akuza fillestare ishin të mjaftueshme. Nuk është dhënë asnjë shpjegim se pse ato prova nuk shiheshin më si të mjaftueshme apo të vlefshme.

231. Procedimi penal ndaj F.M. rifilloi vetëm në vitin 2021, që do të thotë se kishte një boshllëk nëntëvjeçar në ndjekjen e tij penale. Gjatë kësaj periudhe, kërkuesit bënë disa përpjekje për të filluar procedimin penal kundër F.M. Megjithatë, vendosja e barrës mbi kërkuesit, si palë të dëmtuara, për të paraqitur prova për veprat e dyshuara që i nënshtrohen ndjekjes penale të asistuar nga shteti nuk është e pranueshme. Këto dështime ngrenë pyetje serioze për vullnetin dhe kujdesin e prokurorisë për të ndjekur çështjen në përputhje me kërkesat e nenit 2 të Konventës, duke krijuar kështu një mundësi për mosndëshkim. Gjykata vëren, gjithashtu, se vendimi i datës 26 mars 2015 i Gjykatës Administrative të Tiranës, i dhënë ndërkohë, përfshinte gjetje të konsiderueshme mbi përgjegjësinë personale (civile) të F.M. për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të Gërdecit. Edhe pse këto gjetje kishin të bënin me përgjegjësinë e tij civile, ato mund të ishin përdorur në mbështetje të çështjes së prokurorisë kundër F.M.

232. Gjykata rithekson se kërkesa për të vepruar menjëherë dhe me shpejtësi të arsyeshme është e nënkuptuar në kontekstin e detyrimeve të shtetit sipas nenit 2 të Konventës. Edhe aty ku mund të ketë pengesa ose vështirësi që pengojnë ecurinë në një hetim ose një gjykim në një situatë të caktuar, përgjigjja e menjëhershme nga autoritetet është jetike për ruajtjen e besimit të publikut për respektimin e tyre të shtetit të së drejtës dhe për parandalimin e çdo shfaqjeje të bashkëpunimit për, ose tolerancës, ndaj akteve të paligjshme (shihni *Šilih kundër Sllovenisë* [GC], nr. 71463/01, § 195, 9 prill 2009, dhe *Fergec kundër Kroacisë*, nr. 68516/14, § 38, 9 maj 2017).

233. Në këtë çështje, ndjekja penale e F.M. u ndikua nga vonesa të konsiderueshme, inercia e autoriteteve të ndjekjes penale dhe shumë përpjekje të kota të kërkuesve për ta sjellë atë para drejtësisë (shihni paragrafët 103–118 më lart). Gjykata rithekson se drejtësia e vonuar shpesh është drejtësi e mohuar, pasi ekzistenca e periudhave të paarsyeshme të pasivitetit dhe mungesa e kujdesit nga ana e autoriteteve në kryerjen e procedurave e bën hetimin dhe gjykimin joefektiv (krahasoni *Vazagashvili dhe Shanava*, cituar më lart, § 89, me referenca të mëtejshme dhe *Ochigava kundër Gjeorgjisë*, nr. 14142/15, § 58, 16 shkurt 2023).

234. Për sa i përket argumentit të kërkuesve se ndjekja penale kundër F.M. ishte pezulluar për shkak të zbatimit të amnistisë, Gjykata vëren se sipas ligjit për amnistinë, të miratuar më 8 nëntor 2012, amnistia ishte e mundur vetëm në lidhje me veprat penale të dënueshme deri në dy vjet burgim. Ndonëse është e vërtetë se, në vendimin e saj të datës 10 dhjetor 2012, Gjykata e Lartë zbatoi amnistinë për F.M., kjo kishte të bënte vetëm me akuzat sipas nenit 91 të KP për plagosje të rëndë nga pakujdesia. Sidoqoftë, Gjykata e Lartë, më 1 mars 2020, kishte pushuar procedimin penal kundër F.M. me akuza të ngjashme, duke konstatuar mungesë të elementëve të figurës së veprës penale (*mens rea* dhe *actus reus*). Prandaj, vendimi për amnistinë, në rrethanat e çështjes në fjalë, nuk kishte ndikim vendimtar në ndjekjen penale të F.M.

235. Procedimi penal kundër F.M. për shpërdorim detyre është ende në pritje (shihni paragrafin 122 më lart), duke lënë kështu kërkuesit pa një konkluzion përfundimtar në lidhje me përgjegjësinë e tij më shumë se katërmëdhjetë vjet pas ngjarjes së Gërdecit. Ndonëse Gjykata nuk po mban qëndrim në lidhje me përgjegjësinë penale të F.M., ajo vlerëson se, nisur nga rëndësia e veçantë sociale e tragjedisë së Gërdecit dhe provat e mbledhura kundër F.M. (shihni në veçanti letrën e

Prokurorit drejtuar Parlamentit, paragrafi 47 më sipër), kërkuesit si edhe publiku i gjerë kanë të drejtë të dinë jo vetëm rrethanat në të cilat ka ndodhur humbja e jetës dhe plagosjet e rënda (shih *Lapusan kundër Rumanisë*, nr. 29723/03, § 94, 3 qershor 2008 dhe *Shoqata "21 Dhjetor 1989" dhe të Tjerët*, të cituar më sipër, § 144), por edhe rolin e saktë që pati ish-ministri i Mbrojtjes në këto ngjarje.

δ) Konkluzion

236. Në lidhje me procedimin penal kundër njëzet e nëntë të akuzuarve, Gjykata duhet të marrë parasysh: faktin që çështja në fjalë nuk ka të bëjë me vrasje me dashje; natyrën e dënimeve të të akuzuarve kryesorë; dënimet me burg të dhëna ndaj tyre nga gjykatat; dhe kohën që ata kanë vuajtur në burg (duke filluar nga gjashtë vjet e shtatë muaj deri në dhjetë vjet e njëzet e shtatë ditë). Në këto rrethana, Gjykata nuk mund të dalë në përfundimin se sistemi i së drejtës penale, siç zbatohet në çështjen në fjalë, nuk pati efekt të mjaftueshëm bindës që mund të siguronte parandalimin efektiv të akteve të paligjshme siç janë ato për të cilat janë ankuar kërkuesit (krahasoni *Aliun dhe Ayşe Duran*, cituar më sipër, § 72).

237. Në të njëjtën kohë, dhe duke marrë parasysh efektivitetin e përgjithshëm të hetimit (shihni paragrafin 185 më lart), Gjykata ka konstatuar se kërkuesve nuk iu është dhënë mundësia adekuate për të marrë pjesë në proceset gjyqësore kundër të akuzuarve në lidhje me ngjarjen e Gërdecit që u mori jetën të afërmeve të tyre ose u shkaktoi atyre plagë të rënda kërcënuese për jetën (shihni paragrafët 223–227 më lart). Më e rëndësishme akoma, mënyra se si autoritetet shqiptare trajtuan ndjekjen penale të F.M nuk ishte në përputhje me detyrimet e tyre procedurale sipas nenit 2 të Konventës.

238. Gjykata arrin në përfundimin se rrjedhimisht është shkelur detyrimi procedural i nenit 2 të Konventës për shkak të mungesës së përfshirjes së kërkuesve në gjykimin penal të njëzet e nëntë të akuzuarve dhe për shkak të mënyrës se si autoritetet shqiptare kanë trajtuar ndjekjen penale të F.M.

B. Aspekti material i nenit 2 të Konventës

Pranueshmëria

a) Parashtrimet e palëve

239. Qeveria fillimisht parashtrroi se kërkuesit kishin abuzuar me të drejtën e tyre të kërkesës. Përkatesisht, ata i kishin dhënë Gjykatës përshtypje të gabuar duke mos iu referuar procedurave administrative si një rrugë e mundshme për të kërkuar dëmshpërblim.

240. Më tej, Qeveria pretendoi se kërkuesit nuk i kishin shteruar mjetet juridike në vend. Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj kishin marrë dëmshpërblim për vdekjen e djalit të tyre nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe nuk e kishin ankimuar atë vendim. Prandaj, Qeveria arriti në përfundimin se kërkuesit kishin qenë të kënaqur me shumën që u ishte dhënë.

241. Në lidhje me kërkesat nr. 46707/13 dhe 46714/13, Qeveria argumentoi se ato ishin depozituar para kohe sepse kërkuesit nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet juridike të brendshme dhe procedurat administrative në dispozicion, ndërsa disa nga kërkesat e tyre ishin akoma në pritje përpara gjykatave kombëtare. Për sa u përket kërkuesve të tjerë, Qeveria parashtrroi se kërkuesit nuk i kishin shteruar siç duhet të gjitha mjetet juridike të brendshme në dispozicion, sepse ata nuk kishin paraqitur një padi civile për dëmshpërblim.

242. Kërkuesit argumentuan se, në kontekstin e veçantë të çështjes së tyre, i vetmi mjet juridik efektiv që duhej të kishin përdorur, për aq sa ishte e mundur, ishte procesi penal, i cili kishte kulmuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 19 korrik 2013. Fakti që, në bazë të ligjit të brendshëm, kërkuesit (kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14) nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në ato procese nuk kishte asnjë rëndësi nëse procesi penal në çështjen në fjalë ishte i vetmi mjet juridik rezultatin e të cilit kërkuesit duhej të kishin pritur përpara se të depozitonin një kërkesë në Gjykatë; në fakt, kjo mospjesëmarrje, mund të përbënte shkelje të qartë të aspektit procedural të nenit 2. Ata u mbështetën në *Öneryıldız* (cituar më lart, § 113) dhe *Budayeva dhe të tjerët* (cituar më lart, § 140), ku

Gjykata ishte shprehur se vetëm procesi penal do të konsiderohej mjet efektiv, pavarësisht çdo lloj mjeti tjetër juridik në dispozicion të kërkuësve.

243. Duke qenë se ata nuk ishin lejuar të merrnin pjesë në procesin penal në nivel vendor, forma tjetër e mjetit juridik të përmendur ishte e pamjaftueshme. Prandaj, argumentet e paraqitura nga Qeveria nuk ishin relevante.

244. Kërkuësit në kërkesat nr. 46707/13 dhe 467014/13 vunë në dukje se procedimi penal që kishin filluar ishte i vetmi mjet juridik penal në dispozicion të tyre (sepse në rendin juridik shqiptar plagët si ato të pësuar nga kërkuësit nuk ishin objekt i ndjekjes penale të asistuar nga shteti; përkundrazi, viktimës iu kërkua të bënte një kërkesë penale dhe të merrte përsipër zhvillimin e procedimit, duke vepruar si organ akuze). Për më tepër, kërkuësit parashtruan se me paraqitjen e kallëzimeve të tyre penale, atyre u ishte dhënë mundësia për të marrë pjesë në procedimin penal që pasoi, duke paraqitur prova, duke propozuar që dëshmitarët të merreshin në pyetje e kështu me radhë. Kërkuësit pretenduan që vetëm këto procedura, kishin qenë në parim në përputhje me kërkesat procedurale që rrjedhin nga neni 2. Nga ana tjetër, ata pretenduan se nuk kishin në dispozicion një mjet juridik që do t'u mundësonte të kundërshtonin zbatimin e ligjit për amnistinë ndaj të pandehurit në çështjet e tyre dhe të kërkonin vazhdimin e procedimit penal (ata ju referuan, për analogji, *P.M. kundër Bullgarisë*, nr. 49669/07, § 59, 24 janar 2012). Kërkuësit theksuan rëndësinë e faktit se në asnjë moment në proceset e brendshme gjykatat kombëtare nuk e kanë diskutuar statusin e tyre ligjor si palë të dëmtuara ose nuk kanë konsideruar se ankimet e tyre nuk ishin “të diskutueshme”.

245. Gjithashtu, procedura e dëmshpërblimit pranë gjykatave administrative kishte nisur në vitin 2015 për njërën prej kërkuësve (Rabie Gërdeci) në kërkesën nr. 46707/13. Dy kërkuëse të tjera, Sabrie Picari dhe Meltina Haka, kishin marrë dëmshpërblim në proces civil.

246. Për sa u përket kërkuësve në kërkesën nr. 467014/13, Roxhens Durdaj dhe Alketa Hazizaj, ata kishin shprehur gatishmërinë për të paraqitur ankim administrativ dhe për këtë kishin njoftuar Gjykatën.

b) Vlerësimi i Gjykatës

247. Gjykata nuk duhet të trajtojë çështjen e abuzimit të rregullit të së drejtës së kërkesës sepse ankimet e kërkuësve sipas aspektit material të nenit 2 sidoqoftë janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

i. Parime të përgjithshme

248. Gjykata vlerëson se çështjet e statusit të viktimës së kërkuësve dhe shterimit të mjeteve juridike të brendshme janë të lidhura në thelb me rrethanat e çështjes në fjalë dhe për këtë arsye duhet të trajtohen së bashku (krahasoni *Jeronoviçs kundër Letonisë* [GC], nr. 44898/10, § 75, GJEDNJ 2016).

249. Parimet e përgjithshme përkatëse në lidhje me shterimin e mjeteve juridike të brendshme janë përcaktuar në *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* ((kundërshtim paraprak) [GC], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69–75, 25 mars 2014).

250. Në veçanti, Gjykata ka pranuar se neni 35 § 1 duhet të zbatohet me njëfarë shkalle fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. Ajo ka pranuar më tej se rregulli i shterimit nuk është as absolut dhe as i aftë të zbatohet automatikisht; për qëllime të shqyrtimit nëse është respektuar, është thelbësore të merren parasysh rrethanat e çështjes të caktuar. Në veçanti kjo do të thotë që Gjykata duhet të marrë parasysh realisht jo vetëm ekzistencën e mjeteve juridike formale në sistemin ligjor të shtetit kontraktues në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm në të cilin ato veprojnë, si edhe rrethanat personale të kërkuësit. Më pas, ajo duhet të shqyrtojë nëse, në të gjitha rrethanat e çështjes, kërkuësi ka bërë gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tij ose saj për të shteruar

mjetet juridike të brendshme (shihni *Ýlhan kundër Turqisë* [GC], nr. 22277/93, § 59, GJEDNJ 2000 VII).

251. Sa i përket dëmshpërblimit që është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të korrigjuar shkeljen e një të drejte të Konventës në nivel kombëtar, Gjykata në përgjithësi e ka konsideruar këtë si të varur nga të gjitha rrethanat e çështjes, duke pasur parasysh, në veçanti, natyrën e shkeljes së Konventës që është në diskutim (shihni *Gäffen kundër Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, § 116, GJEDNJ 2010).

252. Për sa i përket pagimit të dëmshpërblimit dhe aspektit material të nenit 2, Gjykata është shprehur se në rastet e keqtrajtimit me dashje që rezultojnë në vdekje, shkelja e nenit 2 nuk mund të korrigjohet ekskluzivisht nëpërmjet dhënies së dëmshpërblimit për të afërmit e viktimës. Kjo ndodh sepse, nëse autoritetet do të mund ta kufizonin reagimin e tyre ndaj incidenteve të keqtrajtimit me dashje nga policia thjesht me dhënien e dëmshpërblimit, duke mos bërë mjaftueshëm në lidhje me ndjekjen penale dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, do të ishte e mundur në disa raste që punonjësit e shtetit të abuzonin me të drejtat e atyre që janë nën kontrollin e tyre me pandëshkueshmëri virtuale, dhe ndalimet e përgjithshme ligjore për vrasjen, torturën dhe trajtimin çnjerëzor e poshtërues, pavarësisht rëndësisë së tyre themelore, do të ishin praktikisht joefektive (shihni *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më lart, § 55, dhe rastet e cituara aty).

253. Mundësia për të kërkuar dhe marrë dëmshpërblim përbën vetëm një nga masat e nevojshme për të korrigjuar vdekjen e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i forcës nga punonjësit e shtetit. Masat e tjera të nevojshme për të siguruar korrigjimin janë detyrimi i shtetit për të kryer një hetim efektiv (shihni *Kelly dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 30054/96, § 105, 4 maj 2001, dhe *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më sipër, §§ 56–57; shihni, gjithashtu, *mutatis mutandis*, *Vladimir Romanov kundër Rusisë*, nr. 41461/02, § § 78–79, 24 korrik 2008, dhe *Ablyazov kundër Rusisë*, nr. 22867/05, § 43, 30 tetor 2012). Pyetja nëse hetimi ka arritur të vërtetojë faktet e çështjes dhe të identifikojë personat përgjegjës përmendet në praktikën gjyqësore të Gjykatës si hetim “adekuat” (shihni *Ramsabhai dhe të tjerët*, cituar më lart, § 324, dhe *Hanan*, cituar më lart, § 202).

254. E njëjta gjë vlen edhe në çështjet që kanë të bëjnë me vdekjen e shkaktuar nga pakujdesia e rëndë (shihni, si vendimin kryesor në këtë drejtim, *Öneriyildiz*, cituar më lart, § § 93–94), siç është situata në çështjen në fjalë.

255. Nga praktika gjyqësore e lartpërmendur e Gjykatës, *argumentum a contrario*, rezultojnë se kur autoritetet kanë kryer një hetim adekuat në të cilin janë vërtetuar të gjitha faktet përkatëse dhe janë identifikuar dhe dënuar personat përgjegjës, dhënia e dëmshpërblimit adekuat dhe pranimi i përgjegjësisë së shtetit për vdekjen e të afërmeve të kërkuesve, në parim, do të mjaftonte për t'i hequr kërkuesit statusin e viktimës (krahasoni *Göktepe kundër Turqisë* (vendim), nr. 64731/01, 26 prill 2005).

256. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ajo tashmë ka gjetur se hetimi i kësaj çështjeje ishte adekuat për faktin se përcaktoi rrethanat e çështjes dhe çoi në identifikimin e atyre që ishin përgjegjës (shihni paragrafët 184–97 më lart dhe 259–60 më poshtë; krahasoni *Çakici kundër Turqisë*, nr.23657/94, § 80, GJEDNJ 1999-IV; *Estamirov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 60272/00, § 77, 12 tetor 2006; dhe *Budayeva dhe të tjerët*, cituar më lart § 163).

257. Duke qenë se hetimi ishte adekuat, pyetja tjetër që duhet trajtuar në lidhje me statusin e viktimës së kërkuesve është natyra e korrigjimit të parashikuar në procedurat administrative. Parimet që rregullojnë vlerësimin e statusit të viktimës së kërkuesit janë përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës si më poshtë (shihni, në përgjithësi, *Scordino kundër Italisë* (nr. 1) [GC], nr. 36813/97, §§ 178–92, GJEDNJ 2006 V, dhe, për sa i përket nenit 2 të Konventës, *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më lart, § 49):

a) Sipas parimit të subsidiaritetit, së pari u takon autoriteteve kombëtare të korrigjojnë çdo shkelje të pretenduar të Konventës. Në këtë drejtim, pyetja nëse një kërkues mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së dyshuar është e rëndësishme në të gjitha fazat e procedimit sipas Konventës;

b) Një vendim ose masë në favor të kërkuesit në parim nuk mjafton për t'i hequr atij statusin e "viktimit", përveçse kur autoritetet kombëtare e kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, dhe më pas kanë dhënë dëmshpërblim për shkeljen e Konventës;

c) Aftësia e kërkuesit për të pretenduar se është viktimë do të varet nga korrigjimi i parashikuar sipas mjetit juridik të brendshëm;

d) Parimi i subsidiaritetit nuk do të thotë heqje dorë nga çdo mbikëqyrje e rezultatit të përfutur nga përdorimi i mjeteve juridike të brendshme, përndryshe të drejtat e garantuara nga Konventa do të humbnin thelbin. Në lidhje me këtë, duhet të theksohet se Konventa synon të garantojë jo të drejta teorike apo iluzionare, por të drejta që janë praktike dhe efektive.

258. Gjykata ka vendosur, gjithashtu, se kur gjykatat kombëtare në procese civile kanë vërtetuar lidhjen shkak-pasojë mes dështimit nga ana e autoriteteve shtetërore për të marrë masa parandaluese që synojnë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe aksidentit të kërkuesit, këto gjetje të gjykatave kombëtare përbëjnë pranimin e dështimit nga autoritetet shtetërore për të përmbushur detyrimin pozitiv material sipas nenit 2 të Konventës (shihni *Zinatullin kundër Ruisë*, nr. 10551/10, § 38, 28 janar 2020).

259. Në rastet e pakujdesisë që i ngarkohet shtetit, Gjykata kishte pranuar tashmë se kur një kërkues pranon një shumë dëmshpërblimi në zgjidhjen e kërkesave civile dhe heq dorë nga përdorimi i mëtejshëm i mjeteve juridike të brendshme, ai ose ajo në përgjithësi nuk do të jetë më në gjendje të pretendojë se është viktimë në lidhje me ato çështje (shihni *Chennouf dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 4704/19, § 39, 20 qershor 2023 ; shihni, gjithashtu, *Powell kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 45305/99, GJEDNJ 2000 V *Caraher kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 24520/94, GJEDNJ 2000 I ; *Hay kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 41894/98, 17 tetor 2000; *Bailey kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 39953/07, 5 shtator 2007 dhe *Gray kundër Gjermanisë dhe Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 49278/09, § 83, 18 dhjetor 2012).

ii. Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

260. Në çështjen në fjalë, ankimi i kërkuesve sipas aspektit material të nenit 2 është që autoritetet shtetërore, ndonëse të vetëdijshme për rrezikun për jetën që vinte nga krijimi dhe funksionimi i objektit të Gërdec, i cili ishte në thelb një aktivitet i rrezikshëm, nuk përmbushën detyrimet e tyre pozitive për të marrë masat e duhura të sigurisë.

261. Gjykata duhet të konstatojë nëse proceset që parashikojnë vlerësimin e përgjegjësive së drejtpërdrejtë të shtetit, në lidhje me dështimin e tij për të marrë masat adekuate operationale dhe të sigurisë ose për të siguruar marrjen e këtyre masave nga palët private, dhe dhënien e dëmshpërblimit në këtë drejtim, në parim mund të të konsiderohen se përmbushin detyrimin e shtetit, në lidhje me aspektin material të nenit 2 në rrethanat e çështjes në fjalë.

262. Gjykata vëren se çështja kryesore në lidhje me aspektin material të nenit 2 të Konventës është përgjegjësia institucionale e cila mund të kishte ofruar një bazë për dëmshpërblimin e viktimave, ndërsa përgjegjësia penale individuale e nëpunësve të shtetit është një aspekt i detyrimeve procedurale të shtetit (shihni, përgjithësisht, mbi përgjegjësinë penale individuale në lidhje me ndërhyrjen me dashje në të drejtën për jetë të një personi, paragrafi 212 më lart; shihni, gjithashtu, *Budayeva dhe të tjerët*, cituar më lart, § 112). Aspekti material i nenit 2 në çështjen në fjalë ka të bëjë me një dështim më të përgjithshëm të autoriteteve shtetërore për të kryer siç duhet detyrat e tyre që synojnë mbrojtjen e jetës së atyre që janë nën juridiksionin e tyre. Në lidhje me këto pretendime, i vetmi mjet dëmshpërblimi pas ngjarjes tragjike në fjalë ishte mundësia e kërkuesve për të marrë dëmshpërblim.

263. Për sa i përket bazës ligjore për të kërkuar dëmshpërblim nga shteti, Gjykata vëren se ka disa mundësi. Së pari, Kushtetuta shqiptare i garanton çdokujt të drejtën e kompensimit për dëmin e shkaktuar nga një veprim i paligjshëm, veprim ose mosveprim i një organi shtetëror (neni 44, shih paragrafin 139 më lart). Së dyti, nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil parashikojnë detyrimin e përgjithshëm të kujtudo për të kompensuar dëmin e shkaktuar me faj ose në mënyrë të paligjshme nga një veprim ose mosveprim ndaj një personi tjetër (shihni paragrafin 148 më lart). Së treti, ligji nr. 8510, datë 15 korrik 1999 për përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të administratës shtetërore parashikon përgjegjësinë e organeve të administratës shtetërore për dëmin e shkaktuar nga këto organe, kur: i. kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme; ii. kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshëm të personave fizikë a juridikë privatë; iii. kur, për shkak të mosfunksionimit të mjeteve teknike me të cilat organet e administratës shtetërore ushtrojnë veprimtarinë e tyre, persona fizikë a juridikë privatë cenohen në interesat e tyre të ligjshëm; iv. kur u shkaktojnë një rrezik të vazhdueshëm personave fizikë a juridikë privateë. v. kur kryejnë një akt korruptiv gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (shihni paragrafin 149 më lart). Kështu, Gjykata është e bindur se në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor dhe rregullator adekuat për rrethanat specifike të çështjes në fjalë.

264. Gjithashtu, menjëherë pas aksidentit, Prokuroria e Përgjithshme filloi hetimin për shkaqet e tij dhe u përgatitën raporte ekspertimi, përfshirë dhe atë të përgatitur nga ATF-IRT. Këto raporte dolën në përfundimin, në përgjithësi, që zgjedhja e Gërdecit si vendi i objektit të çmilitarizimit të armëve ishte bërë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e shtetit; procedurat e përdorura në objektin e Gërdecit nuk ishin të sigurta dhe në përputhje me standardet normale të punës në vendet e punës që kanë të bëjnë me eksplozivët dhe lëndët djegëse; çmontimi i municioneve ishte kryer nga punëtorë të patrajnuar duke përdorur automjete të cilat nuk ishin në përputhje me standardet e sigurisë; dhe veshjet e papërshtatshme që prodhojnë statikë ishin lejuar dhe nuk ishte ofruar asnjë trajnim se si të reduktoheshin rreziqet nga elektriciteti statik (shihni paragrafët 21–55 më lart). Kështu, rrethanat ku humbi jeta e të afërmve të kërkuesve ose ku u vu në rrezik jeta e vetë kërkuesve u vërtetuan qartë në ato raporte, të cilat u prodhuan gjatë hetimit.

265. Procedimi penal nuk u ndal me hetimin, por çoi në ngritjen e akuzave ndaj tridhjetë të akuzuarve (shihni paragrafin 62 më lart), për të cilat u paraqitën provat para gjykatave penale që vërtetuan faktet përkatëse dhe shpallën fajtorë disa të akuzuar dhe dhanë dënimet penale ndaj tyre (shihni paragrafin 77 më lart). Kështu, faktet e rëndësishme për një padi civile kundër shtetit u vërtetuan gjatë procesit penal. Prandaj, për sa i përket mundësisë së kërkuesve për të provuar pretendimet e tyre në procesin civil, çështja në fjalë ndryshon nga çështjet e tjera ku hetimi nuk filloi ose nuk çoi në vërtetimin e fakteve përkatëse (krahasoni *Çaku*, cituar më lart, § 80, dhe *Ilhan*, cituar më lart, § 62; *Eremiášová dhe Pechová kundër Republikës Çeke*, nr.23944/04, § § 90 dhe 94, 16 shkurt 2012; dhe *A dhe B kundër Gjeorgjisë*, nr. 73975 /16, § § 35 dhe 43–46, 10 shkurt 2022), të cilat nga ana e tyre ndikuan negativisht në mundësinë e kërkuesve në këto çështje për të pasur sukses me paditë e tyre civile.

266. Nga ana tjetër, Gjykata ka gjetur shkelje të aspektit procedural të nenit 2 në lidhje me hetimin ndaj ish-ministrit të Mbrojtjes për shkak se nuk është marrë një vendim përfundimtar në nivel kombëtar dhe hetimi është cenuar nga mungesa e efikasitetit dhe vonesat e tepruara (shihni paragrafët 224-31 më lart).

267. Megjithatë, ky aspekt nuk mund të vërë në dyshim hetimin përgjithësisht adekuat, siç përshkruhet më sipër. Fakti që procedimi penal nuk përputhej plotësisht me kërkesat procedurale të nenit 2 të Konventës nuk ndikon në faktin që ato procedime çuan në vërtetimin e rrethanave të ngjarjes dhe në dënimet penale të disa personave. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se padia civile e kërkuesve kundër shtetit nuk varej nga rezultati i procedimit penal kundër ish-ministrit të Mbrojtjes.

Në fakt, Gjykata Administrative konstatoi, *inter alia*, se Ministria e Mbrojtjes dhe MEICO, një kompani shtetërore nën autoritetin e ministrit/Ministres së Mbrojtjes, ishin përgjegjëse për pasojat e tragjedisë, sepse ato e kishin ngritur objektin e Gërdecit dhe nuk kishin marrë masat e duhura parandaluese për të shmangur ngjarjen që u kishte shkaktuar dëm kërkuesve. U shpreh se ministri i Mbrojtjes ishte përgjegjës për faktin se ai kishte urdhëruar kryerjen e aktivitetit në një vend të palicencuar për ruajtjen e municioneve, si dhe për autorizimin e kompanive të palicencuara për të operuar teknologjitë e çmilitarizimit. Përgjegjësia objektive e ministrit të Mbrojtjes buronte nga dështimi i tij për të ndërmarrë masa të arsyeshme për të shmangur ose ulur rrezikun kërcënues për jetën nëpërmjet mbikëqyrjes së aktiviteteve të rrezikshme dhe përgjegjësia subjektive e ministrit të Mbrojtjes buronte nga dështimi i tij për të angazhuar forcat e armatosura për të mbikëqyruar aktivitetet e rrezikshme. Prandaj, pavarësisht nga mangësitë e procedimit penal kundër ministrit të Mbrojtjes, Gjykata Administrative përcaktoi përgjegjësinë e tij civile/administrative për ngjarjet në fjalë.

268. Gjithashtu, dhe më e rëndësishme, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë u shpreh se barra e provës i takonte shtetit dhe jo kërkuesve si pretendues të kompensimit për dëmin e shkaktuar nga shpërthimi në objektin e Gërdecit (shihni paragrafin 131 më lart). Kjo i çliroi kërkuesit nga detyra e vështirë për të siguruar prova për pretendimet e tyre dhe për të provuar përgjegjësinë e shtetit (krahasoni *Yaşa kundër Turqisë*, 2 shtator 1998, § 73, *Raportet e vendimeve* 1998 VI; dhe *Budayeva dhe të tjerë*, cituar më lart, §§ 163 dhe 164). Kjo përgjegjësi prezumohej, dhe i takonte shtetit të provonte të kundërtën. Duke pasur parasysh aktet e kërkuara dhe të përgatitura gjatë hetimit, të cilat përcaktuan qartë se autoritetet shtetërore kishin qenë përgjegjëse për ngritjen dhe funksionimin e objektit të Gërdecit dhe për dështimin në marrjen dhe zbatimin e masave adekuate të sigurisë, dhe faktin që aktet shërbyen si prova kryesore në proceset administrative ku kërkuesit pretenduan dëmshpërblim, pozicioni i kërkuesve në ato procese ishte shumë i fortë dhe shteti kishte pak mundësi për të hedhur poshtë përgjegjësinë e tij (krahasoni *Vilnes dhe të tjerë kundër Norvegjisë*, nr. 52806/09 dhe 22703 /10, § 177, 5 dhjetor 2013; *Vovk dhe Bogdanov*, cituar më lart, §§ 74 dhe 76; dhe *Ribcheva dhe të tjerë kundër Bullgarisë*, nr. 37801/16 dhe 2 të tjerë, § 149, 30 mars 2021).

269. Gjykata vëren më tej se gjetjet e gjykatave penale nëse ishte kryer një vepër penale dhe nga kush ishin të detyrueshme për Gjykatën Administrative të Tiranës (shihni nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale, cituar në paragrafin 145 më lart). Në kohën kur Gjykata Administrative e Tiranës mori vendimin e saj për çështjen e kërkuesve (shihni paragrafin 126 më lart), i akuzuari në procedimin penal ishte shpallur tashmë fajtor me një vendim përfundimtar (shihni paragrafin 93 më lart), i cili sigurisht përforcoi pretendimin e kërkuesve në procesin administrativ.

270. Nuk ka asnjë arsye për të besuar se kërkuesit mund të mos kishin kërkuar kompensim në proces civil ose administrativ nga shteti, në lidhje me detyrimet e tij pozitive sipas nenit 2 të Konventës duke u mbështetur në aktet e mësipërme të prodhuara zyrtarisht dhe në bazën ligjore të përmendur më sipër. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren, gjithashtu, se e drejta për jetën garantohet nga Kushtetuta e Shqipërisë (neni 21) dhe se Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Shqipëri. Për të zbatuar parimin e subsidiaritetit dhe për t'i dhënë jetë dispozitave të ligjit të brendshëm që garantojnë të njëjtat të drejta si Konventa, kërkuesve u kërkohet të përdorin mjetet juridike në dispozicion në nivel vendor. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit është një nga parimet themelore mbi të cilat bazohet sistemi i Konventës; makineria për mbrojtjen e të drejtave themelore të krijuara nga Konventa është ndihmëse e sistemeve kombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut (shihni, mes vendimeve të tjera, *Vučković dhe të tjerët*, cituar më lart, § 69, dhe *Habulinec dhe Filipović kundër Kroacisë* (vendim) nr. 51166/10, § 26, 4 qershor 2013).

α) Zamira Durdaj, Feruzan Durdaj dhe Sabrije Picari

271. Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj kanë depozituar një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku kanë kërkuar dëmshpërblim për vdekjen e djalit të tyre. Gjykata e shkallës së parë pranoi pjesërisht padinë e tyre dhe u dha atyre 8,699,381 lekë për dëmin pasuror dhe jopasuror për humbjen e djalit të tyre (shihni paragrafin 125 më lart).

272. Sabrije Picari ka paraqitur edhe një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror në lidhje me rrezikun për jetën e saj të shkaktoar nga shpërthimi në objektin e Gërdecit. Ajo u dëmshpërblye me 11,049,837 lekë për dëmin pasuror dhe 6,761,029 lekë për dëmin jopasuror (shihni paragrafin 137 më lart).

273. Për sa i përket çështjes nëse gjykatat kombëtare e pranuan shkeljen e Konventës, Gjykata vëren se, ndërkohë që duket se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk deklaroi shprehimisht se ishte shkelur e drejta e kërkuarve për jetën sipas nenit 2 të Konventës ose ekuivalentit të tij kushtetues, ajo i dëmshpërbleu kërkuarve për vdekjen e djalit të tyre në rastin e Zamira Durdajt dhe Feruzan Durdajt dhe për rrezikun për jetën e saj në rastin e Sabrije Picarit. Në këtë mënyrë, Gjykata Administrative e Tiranës konstatoi se autoritetet shtetërore nuk kishin marrë masat e duhura parandaluese për të garantuar respektimin e standardeve minimale të sigurisë në objektin e Gërdecit (shih paragrafët 126, 127 dhe 131 më lart); proceset e punës në objektin e Gërdecit qenë kaotike dhe aktivitetet e çmilitarizimit ishin kryer pa licencat e kërkuara; punonjësit nuk ishin trajnuar si duhet për kryerjen e një pune të tillë; aktivitetet ishin kryer në kundërshtim me rregulloret teknike ushtarake; vendndodhja nuk kishte plotësuar kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 14 mars 2007 (shihni paragrafët 128, 129 dhe 131 më lart); dhe ngritja e objektit të Gërdecit dhe funksionimi i tij nuk ishte monitoruar apo mbikëqyrur nga autoritetet shtetërore përgjegjëse (shihni paragrafët 128, 129 dhe 131 më lart). Gjykata Administrative doli në përfundimin se aktivitetet e rrezikshme në objektin e Gërdecit kishin rezultuar në vdekjen e djalit të kërkuarve (shihni paragrafët 125 dhe 130 më lart) dhe plagosjen e kërkuarve të tjerë (shihni paragrafët 130 dhe 137 më lart). Sipas Gjykatës, këto gjetje përbëjnë pranimin në thelb të përgjegjësisë së shtetit për vdekjen e djalit të kërkuarve dhe dështimin e shtetit për të mbrojtur jetën e tij në rastin e Zamira Durdajt dhe Feruzan Durdajt dhe për rrezikun për jetën e saj në rastin e Sabrije Picarit (krahasoni *Zinatullin*, cituar më lart, § 38).

274. Për sa i përket shumës që ju dha Zamira Durdajt dhe Feruzan Durdajt, Gjykata së pari vëren se ata nuk kanë paraqitur ankim, pavarësisht se kanë pasur mundësinë për ta bërë këtë. Duke mos depozituar ankim, kërkuarve pranojnë në heshtje se janë të kënaqur me shumën e caktuar. Nga kjo rrjedh se ata hoqën dorë nga përdorimi i mëtejshëm i mjeteve juridike kombëtare.

275. Më tej, Gjykata vëren se Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj, si edhe Sabrije Picari, morën dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën jo më të ulët se ato që Gjykata ka dhënë sipas nenit 41 të Konventës në raste të krahasueshme (krahasoni *Budayeva dhe të tjerët*, cituar më lart, § 205; *Vovk dhe Bogdanov*, cituar më lart, § 81; *Cevrioğlu kundër Turqisë*, nr. 69546/12, § 87, 4 tetor 2016; dhe *Lovygin kundër Ukrainës*, nr. 22323/0 § 120, 23 qershor 2016).

276. Rrjedhimisht, këta kërkuarve nuk mund të pretendojnë më se janë viktimat e shkeljes së pretenduar sipas aspektit material të nenit 2 të Konventës, sepse duhet të supozohet se ata u mjaftuan me dëmshpërblimin e dhënë dhe në çdo rast dëmshpërblimi që u dha ishte i mjaftueshëm, ose që ata nuk i kanë shteruar mjetet juridike të brendshme (krahasoni *Murillo Saldias dhe të tjerët kundër Spanjës* (vendim) nr. 76973/01, 28 nëntor 2006), sepse nuk kanë paraqitur ankim kundër vendimit të shkallës së parë dhe, në rast se ata do të ishin të pakënaqur me rezultatin e ankimit të tyre, mjete të tjera juridike ishin në dispozicion, përkatësisht rekursi në Gjykatën e Lartë dhe, ndoshta, një ankim kushtetues.

β) Kërkuarve të tjerë

277. Për sa u përket kërkesve të tjerë, Gjykata vëren se ata nuk kanë paraqitur asnjë provë për depozitim e padisë civile ose administrative për dëmshpërblim kundër shtetit.

278. Rrjedhimisht, kërkesit që nuk kanë depozituar padi civile kundër shtetit, në lidhje me ankimin e tyre material sipas nenit 2 të Konventës nuk i kanë shteruar siç duhet mjetet juridike të brendshme dhe rrjedhimisht nuk i kanë dhënë autoriteteve kombëtare mundësinë – që në parim synohet t'u jepet shteteve kontraktuese, sipas nenit 35 § 1 të Konventës - për të adresuar (dhe për të parandaluar ose rregulluar) shkeljen e caktuar të Konventës të pretenduar ndaj tyre (shihni, për shembull, *Shoqata Dëshmitarët e Jehovait kundër Francës* (vendim). 8916/05, 21 shtator 2010; *Habulinac dhe Filipović*, cituar më lart, § 30; *Merot d.o.o dhe Storive Tir d.o.o kundër Kroacisë* (vendim), nr. 29426/08 dhe 29737/08, § 38, 10 dhjetor 2013; dhe *Peacock kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), nr. 52335/12, § 40, 5 janar 2016).

iii. Konkluzioni në lidhje me pranueshmërinë e ankimit sipas aspektit material të nenit 2 të Konventës

279. Në këto rrethana, ankimi sipas aspektit material të nenit 2 të Konventës duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1, 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

280. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

A. Dëmi

281. Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj (kërkesat nr. 63543/09 dhe 12720/14) kërkuar nga 25,000 euro (EUR) secili për dëmin jopasuror. Kërkesit e tjerë (kërkesat nr. 46707/13 dhe 46714/13) kërkuar 10,000 euro për dëmin jopasuror.

282. Qeveria kundërshtoi pretendimet e kërkesve me argumentin se ishin të pabazuara.

283. Gjykata së pari vëren se shkelja e konstatuar lidhet vetëm me aspektin procedural të nenit 2. Në proceset e brendshme, disa prej kërkesve iu dha kompensim *inter alia* për shkak të vuajtjes nga vdekja e të afërmit të tyre të ngushtë (shihni paragrafin 125 më lart), ose për shkak se ata vetë kishin pësuar plagë të rënda (shihni paragrafin 137 më lart). Megjithatë, ky kompensim nuk ka të bëjë me dëmin jopasuror për defektet procedurale të vërtetuara nga Gjykata dhe prandaj nuk mund të merret parasysh. Gjykata vlerëson se kërkesit kanë pësuar dëm jopasuror, i cili nuk mund të kompensohet vetëm me gjetjen e shkeljes dhe për rrjedhojë duhet të jepet kompensim. Duke bërë vlerësimin e saj mbi baza të drejta, siç kërkohet nga neni 41 i Konventës, Gjykata i akordon Zamira Durdajt dhe Feruzan Durdajt së bashku 12,000 euro dhe kërkesve të tjerë 10,000 euro secili për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet atyre.

B. Kosto dhe shpenzime

284. Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj, gjithashtu, kërkuar 1,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave të brendshme dhe 8,300 euro për ato të bëra para Gjykatës. Kërkesit e tjerë kërkuar 1,500 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave të brendshme dhe 5,550 euro për ato të bëra përpara Gjykatës.

285. Qeveria pretendoi se shumë e pretenduara ishin të tepruara dhe të pavërtetuara.

286. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, një kërkes ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë sa provohet se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme sa i përket shumës. Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh dokumentet që disponon dhe kriteret e mësipërme, si dhe faktin që të gjithë kërkesit përfaqësohen nga i njëjti avokat, Gjykata e konsideron të arsyeshme të akordojë shumën prej 8,000 euro për të gjithë kërkesit së bashku që mbulon kostot sipas të gjitha zërave, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet atyre.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. *vendos* të bashkojë kërkesat;
 2. *shpall* të pranueshëm ankimin në lidhje me aspektin procedural të nenit 2 të Konventës dhe të papranueshme pjesën tjetër të kërkesave;
 3. *vendos* se është shkelur aspekti procedural i nenit 2 të Konventës;
 4. *vendos*:
 - a) se shteti i paditur duhet t'u paguajë kërkuessve, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme:
 - i. për dëmin jopasuror, bashkërisht Zamira Durdajt dhe Feruzan Durdajt, 12 000 euro (dymbëdhjetë mijë euro), plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet;
 - ii. për dëmin jopasuror kërkuessve të tjerë, 10,000 (dhjetë mijë euro) secilit, plus çdo taksë që mund të paguhet;
 - iii. për kostot dhe shpenzimet, bashkërisht për të gjithë kërkuessit, 8,000 (tetë mijë euro) euro, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet atyre;
 - b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, interes i thjeshtë të paguhet për shumat e mësipërme sipas normës të njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje;
 5. *rrezon* pjesën tjetër të pretendimit të kërkuessve për kompensim të drejtë.
- Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 7 nëntor 2023 sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
KANCELAR

Pere Pastor Vilanova
PRESIDENT

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe rregullin 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, mendimi paralel i gjyqtarit Grozev i bashkëngjitet këtij vendimi.

P.P.V.
M.B.

MENDIMI PARALEL I GJYQTARIT GROZEV

Edhe pse votova me shumicën për të gjitha gjetjet e këtij vendimi, nuk munda ta ndiqja atë në lidhje me një nga shkaqet për të cilat u konstatua shkelje e aspektit procedural sipas nenit 2. Konkretisht, refuzimi i gjykatës së faktit për të bashkuar padinë civile të kërkuessve me procesin penal dhe mungesa e çdo mundësie tjetër që kërkuessit të legjitimoheshin në procesin penal përpara gjykatave kombëtare (shihni paragrafët 223–227 të këtij vendimi). Të gjithë të akuzuarit në këtë proces penal u shpallën fajtorë dhe morën dënimet adekuate, gjë që për mendimin tim përjashton çdo pretendim nga kërkuessit sipas aspektit procedural të nenit 2. Gjetja e shkeljes me këtë vendim bazohet kështu në një zgjerim të detyrimit të shteteve të paditura për të hetuar humbjen e jetës, e cila nuk është as e nevojshme dhe as e justifikuar. Ky interpretim dhe zbatim i ri i parimeve që rregullojnë detyrimin procedural sipas nenit 2, distancohet nga vetë baza mbi të cilën u krijua detyrimi në radhë të parë, pra nga vërtetimi i fakteve përkatëse që çuan në humbjen e jetës dhe ndëshkimi i përgjegjësve. Kjo qasje e re rrezikon të krijojë konfuzion, pasi ngre pyetje në lidhje me zbatimin e saj në të ardhmen, të cilat nuk kanë përgjigje të qarta dhe koherente.

Kundërshtimi im për gjetjen e një shkeljeje për shkak të mungesës së legjitimitetit të kërkuessit në gjykimin penal nuk bazohet në asnjë dyshim për rëndësinë e përfshirjes së viktimave në hetimet penale. Kjo është një garanci e rëndësishme për efektivitetin e hetimit të kërkuar sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës. Megjithatë, e drejta për përfshirjen e viktimave në proces nuk është një e drejtë më

vete, por vetëm një element, mes disa të tjerëve, i së drejtës për një hetim efektiv për humbjen e jetës ose pretendimet e besueshme për trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Kjo e drejtë është zhvilluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës ndër vite si një garanci procedurale që fajtorët për krimet më të rënda kundër jetës dhe integritetit fizik të mos mbeten të pandëshkuar, gjë që do të minonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit (shihni *Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 5878/08, § 237, 30 mars 2016). Gjykata e ka përkufizuar këtë të drejtë procedurale si detyrë e shteteve të paditura për të penguar kryerjen e veprave penale kundër personit, të mbështetur nga makineria e zbatimit të ligjit për parandalimin, goditjen dhe ndëshkimin e shkeljeve të dispozitave efektive të ligjit penal (shihni *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* [GC], nr. 24014/05, § 171, 14 prill 2015). Elementët e ndryshëm të një hetimi efektiv të shprehur nga Gjykata në vendimet e saj, veçanërisht hetimi i pavarur, adekuat, i plotë, afati kohor, pjesëmarrja e viktimave ose të afërmeve janë pikërisht këto, elemente të përdorura për të vlerësuar nëse ka qenë i justifikuar mosndëshkimi nga shteti i paditur i shkeljeve të dispozitave të legjislacionit të brendshëm penal. Sapo ky detyrim themelor i shtetit të paditur të jetë përmbushur në mënyrë efektive dhe ata që janë përgjegjës për humbjen e jetës ose trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës sipas neneve 2 ose 3 të jenë shpallur fajtorë dhe të jenë ndëshkuar, nuk është më i mundur diskutimi i elementëve individualë të një hetimi efektiv. E thënë thjesht, këto elemente individuale të një hetimi efektiv nuk janë të drejta më vete.

Megjithatë, qasja e kundërt është pikërisht ajo që është miratuar në rastin konkret për gjetjen e shkeljes së detyrimit procedural sipas nenit 2. Kjo përkundër faktit se të gjithë të akuzuarit në procesin penal u shpallën fajtorë dhe u dënuan dhe, siç është shprehur Gjykata, kërkuesit ishin mjaftueshëm të përfshirë në procedurat në fazën e hetimit dhe dënimit e dhëna ishin adekuate (shihni paragrafët 210 dhe 222 të këtij vendimi). Për herë të parë, Gjykata ka zgjedhur të gjejë shkelje të së drejtës procedurale sipas neneve 2 ose 3 të Konventës në një çështje kur përgjegjësit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar në mënyrë adekuate. Më tej, arsyetimi në mbështetje të këtij konstatimi nuk e vlerëson ankimin nën dritën e parimit të zbatueshëm që të afërmit e viktimës duhet të përfshihen në proces në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë (shihni *Al-Skeini dhe Të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 55721/07, § 167, GJEDNJ 2011). Interesi legjitim për përfshirjen e kërkuesve nuk është identifikuar dhe nuk është analizuar nëse dhe në çfarë mase refuzimi për të shqyrtuar padinë civile brenda procesit penal ka pasur ndikim në efektivitetin e ndjekjes penale. Kështu, e vetmja mënyrë për të kuptuar konkluzionin se ka pasur shkelje të të drejtave të kërkuesve si rezultat i mospjesëmarrjes së tyre në procesin penal, është që kjo pjesëmarrje në procesin penal të konsiderohet si një e drejtë më vete, e shkëputur plotësisht nga detyrimin themelor për një hetim efektiv dhe për ndjekjen penale dhe dënimin e përgjegjësve për humbjen e jetës.

Megjithatë, krijimi i një të drejte të tillë të veçuar, të pavarur çon në shfaqjen e një sërë pyetjesh të vështira, për të cilat nuk ka përgjigje të dukshme dhe të lehta. Nëse një nga elementët e përdorur nga Gjykata për të vlerësuar efektivitetin e hetimit mund të veçohet për të gjetur një shkelje, pavarësisht nga fakti se qëllimi themelor i ekzistencës së saj është arritur, cilët elementë të tjerë mund të vlerësohen veçmas po njësoj? A do të shqyrtojë Gjykata veçmas, sipas neneve 2 dhe 3, ankimet për pavarësinë, refuzimet për të pranuar kërkesat për prova, gjetjet e faktit dhe kohëzgjatjen e procedimit penal, edhe nëse personat përgjegjës janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar në mënyrë adekuate? Nëse këta elementë të hetimit efektiv nuk janë më vetëm kaq, domethënë elementë të përdorur për të vlerësuar rezultatin e përgjithshëm të procedimit penal, por bëhen të drejta të veçanta, atëherë cilat janë mjetet juridike të brendshme përkatëse? Në rastin konkret, refuzimi për të shqyrtuar padinë civile të kërkuesve u ankimua dhe vendimi përfundimtar përkatës u miratua shumë kohë përpara përfundimit të procesit penal. A fillon afati gjashtëmuor që nga ky vendim, sikurse do të duhej nëse

do të ishte një e drejtë më vete, e pavarur, e palidhur me përfundimin e çështjes penale? Nëse po, atëherë ky ankim për mungesën e legjitimitimit në gjykimin penal duhet të shpallet i papranueshëm për disa nga kërkuesit sepse është jashtë afatit (shihni paragrafët 67–68 të këtij vendimi). Nëse ekziston një e drejtë e veçuar, e pavarur sipas neneve 2 dhe 3 që një viktimë të marrë pjesë në gjykimin penal, cila është lidhja midis kësaj të drejte të veçuar dhe nenit 6, kur nuk ekziston një e drejtë e tillë? Dhe në fund, cilat do të ishin detyrimet e shteteve të paditura për zbatimin e vendimit të Gjykatës? Rihapja e proceseve penale të brendshme për t'i dhënë kërkuesit legjitimitim, pa ndryshuar asgjë në rezultatin e këtyre proceseve, nuk është as në interes të vetë kërkuesve.

Pjesëmarrja efektive e përmirësuar e viktimave të krimit në procese penale do të ishte padyshim një zhvillim i lavdërueshëm. Vetë Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar rekomandime në këtë drejtim (shihni paragrafin 155 të këtij vendimi). Megjithatë, zhvendosja nga rekomandimi i kësaj pjesëmarrjeje drejt krijimit të një të drejte të veçuar, të pavarur për të marrë pjesë në proceset penale sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës është një hap domethënës dhe i cili, kam frikë, nisur nga konfuzioni dhe mospërputhja që do të shkaktonte, mund të dëmtojë në vend që të forcojë mbrojtjen e të drejtave individuale sipas Konventës.

SHTOJÇË

Lista e çështjeve:

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
1.	63543/09	Durdaj kundër Shqipërisë	Zamira Durdaj 1971 Gërdec Shqiptare	Dorian Matlija
2.	46707/13	Selami dhe të tjerët kundër Shqipërisë	Aishe Selami 2002 Tiranë Shqiptare Pashk Kaçi 1951 Tiranë Shqiptar Mirela Hazizaj 1985 Tiranë Shqiptare Miselda Zguri 2002 Tiranë Shqiptare Medi Celami 1979 Tiranë Shqiptar	Dorian Matlija

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
			<p>Rabie Gërdeci 1978 Tiranë Shqiptare</p> <p>Shaban Brahushi 1960 Berat Shqiptar</p> <p>Sabrie Picari 1967 Tiranë Shqiptare</p> <p>Dylbere Prini 1962 Tiranë Shqiptare</p> <p>Adelina Cani 1990 Tiranë Shqiptare</p> <p>Meltina Haka 1992 Tiranë Shqiptare</p> <p>Bege Aliu 1933 Tiranë Shqiptare</p> <p>Esmeralda Sefaj 1979 Tiranë Shqiptare</p>	
3.	46714/13	Durdaj dhe Hazizaj kundër Shqipërisë	<p>Roxhens Durdaj 1997 Tiranë Shqiptar</p> <p>Alketa Hazizaj 1978 Vorë Shqiptare</p>	Dorian Matlija
4.	12720/14	Zamira Durdaj dhe Feruzan Durdaj kundër Shqipërisë	<p>Zamira Durdaj 1971 Gërdec Shqiptare</p>	Dorian Matlija

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Kërkues Viti i lindjes Vendi i qëndrimit Shtetësia	Përfaqësuar nga
			Feruzan Durdaj 1968 Tiranë Shqiptar	